



# RAPORTI I PROGRESIT TË **KOMPAKTIT**

VLERËSIMI I PROGRESIT PËR PERIUdhËN KORRIK 2017 – QERSHOR 2018

## **PËRMBAJTJA**

PARATHËNIE.....	2
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	3
KOMPAKT 3.....	5
POLICIA & DOGANA.....	9
POLICIA E KOSOVËS .....	10
POLICIA NË KOMUNITET .....	10
FUNKSIONIMI I POLICISË NË BAZË TË ANALIZAVE DHE TË DHËNAVE.....	11
DHUNA SEKSUALE DHE NË BAZË GJINORE .....	12
NJËSITË E SPECIALIZUARA DHE EKIPET PËR REAGIM TË SHPEJTË.....	12
POLICIA E KOSOVËS NË VERI TË KOSOVËS .....	14
INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS.....	16
DOGANA E KOSOVËS DHE POLICIA KUFITARE E KOSOVËS .....	17
DREJTËSIA .....	19
MONITORIMI I RASTEVE TË PËRZGJEDHURA TË KOSOVËS .....	20
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS .....	21
KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS.....	23
DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME.....	24
KOLEGJI I APELIT TË AGJENCISË KOSOVARE TË PRONËS .....	26
SHËRBIMI KORREKTUES I KOSOVËS .....	29
INSTITUTI I MJEKËSISË LIGJORE .....	31
ZBATIMI I DIALOGUT .....	32
REGJISTRI CIVIL.....	33
LIRIA E LËVIZJES .....	34
MARRËVESHJA PËR MIK .....	35
INTEGRIMI I DREJTËSISË.....	36
LISTA E SHKURTESAVE.....	38

## PARATHËNIE

Institucionet kosovare të sundimit të ligjit e kanë arritur një nivel të rëndësishëm pasi EULEX-i është tërhequr nga një numër institucionesh më 14 qershor të vitit 2018. Gjatë periudhës që e mbulon ky raport, EULEX-i e ka përgatitur terrenin për tërheqjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve ekzekutivë të tij nga sistemi i drejtësisë, përderisa ka filluar ta bëjë edhe dorëzimin e dosjeve të lëndëve që kanë mbetur nën kujdesin e tij. Për këtë proces është kërkuar angazhimi i shtuar i qeverisë dhe institucioneve të saj.

*Bordi i Përbashkët Bashkërendues për Sundimin e Ligjit (BPSL-ja) është mekanizëm bashkërendues për sundimin e ligjit i përbërë nga institucionet kosovare, Përfaqësuesja Speciale e Bashkimit Evropian/Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe EULEX-i. Ky Bord synon t'i realizojë objektivat e përbashkëta që kanë të bëjnë me angazhimet e BE-së për reforma në fushat kryesore të sundimit të ligjit. BPSL-ja i përcakton objektivat specifike të përbashkëta në formë të një Marrëveshjeje KOMPAKTE dhe Udhërrëfjesit të BPSL-së, ndërsa takohet rregullisht për ta shqyrtuar përparimin e bërë dhe për të rënë dakord për veprimet vijuese për tejkalimin e pengesave.*

Si rezultat i kësaj, ka filluar ndryshimi i kornizës ligjore në fushat përkatëse, kanë filluar të bëhen planet për zëvendësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it, ndërsa ka vazhduar pranimi i një numri të konsiderueshëm të dosjeve të lëndëve. Për më shumë, duke i pranuar performancën dhe kapacitetet e shtuara të disa institucioneve të sundimit të ligjit, EULEX-i ka filluar që ta tërheq gradualisht mbështetjen e tij në formë të monitorimit, mentorimit dhe këshillimit për Policinë e Kosovës, Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe Agjencinë e Regjistrimit Civil. Ndërsa ende janë disa zbrazëtira institucionale dhe dobësi strukturore, Bashkimi Evropian do ta vazhdojë mbështetjen e tij për këto institucione përmes një roli këshillues më të kufizuar me anë të mjeteve alternative të asistencës, përfshirë një numër projektsh të Instrumentit të Para-Anëtarësimit (IPA-s).

Ky raport ofron një përmbledhje të progresit që është bërë gjatë vitit të kaluar në fushat prioritare për të cilat kanë rënë dakord anëtarët e Bordit të Përbashkët Bashkërendues për Sundimin e Ligjit, ndërsa e thekson rrugën përpara në fushat në të cilat ka ndryshuar angazhimi i EULEX-it. Në kohën kur mbështetja e BE-së për institucionet kosovare të sundimit të ligjit është duke ndryshuar, të gjithë ne e konfirmojmë përsëri përkushtimin tonë për t'i adresuar sfidat e mbetura.

Ministri i Drejtësisë  
**Abelard Tahiri**

Kryesuesi i Këshillit  
Gjyqësor të Kosovës  
**Nehat Idrizi**

Kryesuesi i Këshillit  
Prokurorial të Kosovës  
**Blerim Isufaj**

Shefja e Misionit të Bashkimit Evropian  
për Sundimin e Ligjit në Kosovë  
**Alexandra Papadopoulou**

Përfaqësuesja Speciale e BE-së në Kosovë/  
Shefja e Zyrës së BE-së në Kosovë  
**Nataliya Apostolova**

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Gjatë periudhës që e mbulon ky raport – ndërmjet muajit korrik 2017 dhe qershor 2018 – institucionet kosovare të sundimit të ligjit kanë bërë përparime të rëndësishme në zhvillimin e sektorit të sundimit të ligjit. Ky raport e ofron një përmbledhje të progresit të bërë në disa institucione të sundimit të ligjit dhe fusha tematike të caktuara, ndërsa i vë në pah mangësitë e mbetura të cilat kërkojnë vëmendje të mëtejshme. Zvogëlimi i konsiderueshëm i rolit të EULEX-it në mandatin e tij të ri që ka filluar në muajin qershor 2018 është dëshmi e përpjekjeve të përbashkëta drejt krijimit të institucioneve efektive, të qëndrueshme dhe llogaridhënese të sundimit të ligjit.

Policia e Kosovës (PK) ka vazhduar me një nivel të pranueshëm të qëndrueshmërisë dhe llogaridhënies gjatë ofrimit të shërbimeve policore. Ende janë të pranishme disa zbrazëti dhe mangësi, veçanërisht në mbajtjen e numrit të mjaftueshëm të personelit të trajnuar për fusha tematike të ndryshme, si dhe në sigurimin e nivelit të standardizuar të pajisjeve në kuadër të një numri të fushave të operimit. Megjithatë, vazhdojnë të ekzistojnë disa çështje të caktuara kontekstuale sa i përket funksionimit të PK-së në veri të Kosovës. Inspektorati Policor i Kosovës (IPK), në ndërkohë, është ballafaquar me një numër sfidash serioze të brendshme si dhe të keqmenaxhimit: këto çështje kanë ndikuar seriozisht në funksionalitetin e tij. Dogana e Kosovës ka arritur një sukses tjetër të dukshëm lidhur me arkëtimin e të hyrave për vitin 2017, si dhe ka arritur rezultate pozitive sa i përket zbatimit të ligjit.

EULEX-i ka vazhduar monitorimin e rasteve të përzgjedhura dhe i ka identifikuar një numër mangësish që ndikojnë në ndarjen e drejtësisë nëpër gjykatat e Kosovës, mes të cilave më të shpeshtat janë “seancat joproduktive”: rastet kur seancat gjyqësore mbahen, por pastaj

menjëherë ndërpriten. Gjykatat vazhdojnë të përballen me një sërë problemesh, siç janë vonesat në procedurat ligjore, regjistrat gjyqësorë jo mirë të mirëmbajtur, si dhe infrastruktura joadekuatë e gjykatave, e cila ka nevojë për vëmendje të mëtejme nga autoritetet vendase në mënyrë që të fuqizohet sistemi i sundimit të ligjit.

Puna e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK-së) është përmirësuar në krahasim me vitin paraprak. Megjithatë, nevojiten përpjekje të mëtejme për ta rritur qëndrueshmërinë institucionale të tij. Po ashtu, puna e Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK-së) ka vijuar të përmirësohet. Të dy këshillat i kanë administruar të gjitha proceset e përzgjedhjes dhe punësimit në përputhje me aktet nënligjore të tyre. Për ta rritur llogaridhënien dhe transparencën e tij, KPK-ja gjithashtu e ka përgatitur një strategji komunikimi për sistemin prokurorial të tij.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme (DHPGJS) dhe Paneli për Ankesa i Agjencisë Kosovare të Pronës (AKP) ka vazhduar me gjykimin e lëndëve me ritmin e saj të zakonshëm. Pas përfundimit të mandatit ekzekutiv gjyqësor të tij, gjyqtarët e EULEX-it i kanë përfunduar detyrat e tyre në këto gjykata më 14 qershor 2018, duke ua dorëzuar këto përgjegjësi kolegëve të tyre vendas. Ndryshimi i Ligjit për DPGJS-në që parasheh zëvendësimin e gjyqtarëve të EULEX-it me ata vendas duhet të miratohet nga Kuvendi, kurse korniza ligjore për Panelin për Ankesa të AKP-së gjithashtu kërkon ndryshime. Në ndërkohë, DHPGJS-ja dhe Paneli për Ankesa i AKP-së kanë ndalur së gjykuari rastet. Me anë të lehtësimit nga ana e EULEX-it, është arritur një zhblllokim duke e krijuar një mekanizëm për dorëzim ashtu që Paneli për Ankesa i AKP-së t’ua dorëzojë

aktgjykimet palëve të cilat janë larguar nga Kosova.

Shërbimi Korrektues i Kosovës (SHKK-ja) ka treguar shenja modeste në zhvillimin e tij drejt standardeve të BE-së. Megjithëse janë vërejtur përmirësime, SHKK-ja u është nënshtruar ndërhyrjeve politike, të cilat në disa raste janë manifestuar në një trajtim preferencial të të burgosurve të profilit të lartë. Në ndërkohë, rekrutimi i personelit të SHKK-së deri në një farë mase ka mbetur sfidues.

Instituti i Mjekësisë Ligjore (IML-ja) e ka vazhduar punën e tij për identifikimin dhe lokalizimin e personave të pagjetur si pasojë e konfliktit të vitit 1999, që është shumë me rëndësi për procesin e pajtimit pas konfliktit. Por, nevojiten hapa shtesë për ta krijuar një kuadër institucional funksional. Në nivelin operativ, IML-ja ka bërë përpjekje për ta arritur nivelin e mjaftueshëm të produktivitetit pasi që personelit i duhet ndihmë dhe trajnim i mëtejshëm.

Në Dialogun e lehtësuar nga BE-ja, ka ndodhur një e arritur e konsiderueshme në tetor të vitit

2017, kur 40 gjyqtarë serbë të Kosovës dhe 13 prokurorë serbë të Kosovës i janë bashkuar gjyqësorit të Kosovës siç ishte paraparë në Marrëveshjen për Drejtësinë. Ndërsa kjo marrëveshje tashmë është zbatuar formalisht, mbetet ende shumë punë përpara se institucionet gjyqësore në veri të Kosovës të bëhen plotësisht funksionale. Progresi ka qenë i ngadaltë dhe jokonsekuent në fushat tjera të lidhura me dialogun, siç është regjistrimi civil, MIK dhe Liria e lëvizjes.

Përderisa i kanë bërë një vlerësim progresit të arritur, anëtarët e BPSL-së e rikonfirmojnë përkushtimin e tyre për ta zhvilluar edhe më tej sektorin e sundimit të ligjit në përputhje me standardet evropiane. Pasi EULEX-i ka filluar të tërhiqet dhe ta rifokusojë mbështetjen e tij në një numër të sferave gjatë gjysmës së parë të 2018, përgjegjësia gjithnjë e më shumë ka kaluar tek institucionet kosovare të sundimit të ligjit. Tani ka ardhur koha për to që t'i dëshmojnë kapacitetet dhe mundësitë e tyre si institucione plotësisht të pavarura. Ndërkohë, BE-ja është në dispozicion për ta vazhduar përkrahjen e saj përmes një numri të instrumenteve në dispozicion.





## **BORDI I PËRBASHKËT BASHKËRENDUES PËR SUNDIMIN E LIGJIT**

### **MARRËVESHJA KOMPAKTE 3**

Për objektivat e përbashkëta në fushën e Sundimit të Ligjit për periudhën deri në qershor të vitit 2018

**Institucionet kosovare për sundimin e ligjit, Shefja e Zyrës së BE në Kosovë/Përfaqësuesja Speciale e BE dhe Misioni EULEX Kosova,**

*Duke i theksuar* arritjet nga zbatimi i Marrëveshjes Kompakte 2 të nënshkruar më 14 maj të vitit 2015 të mbikëqyrur nga Bordi i Përbashkët Bashkërendues për Sundimin e Ligjit (BPSL-ja);

*Duke e pranuar* nevojën që autoritetet kosovare të bashkëpunojnë në mënyrë efektive me Misionin EULEX Kosova dhe PSBE-në/Zyrën e BE-së për arritjen e progresit të mëtejshëm në sektorin e sundimit të ligjit drejt arritjes së synimeve të Marrëveshjes Kompakte dhe përmbushjes së aspiratave të Kosovës për anëtarësim në BE;

*Duke e theksuar* zotimin e institucioneve kosovare për sundimin e ligjit për t'i zbatuar strategjitë dhe planet ekzistuese të tyre për fuqizimin e mëtejshëm të sundimit të ligjit dhe për të punuar me PSBE-në/Zyrën e BE-së dhe EULEX Kosova për avancimin e agjendës së përbashkët;

*Duke e theksuar* zotimin e institucioneve kosovare për sundimin e ligjit për të shënuar progres të mëtejshëm drejt qëndrueshmërisë dhe llogaridhënies si dhe për ta zhvilluar dhe fuqizuar një sistem

të pavarur dhe shumetnik të drejtësisë dhe një polici dhe doganë shumetnike të lira nga ndërhyrja politike dhe korrupsioni, që i respektojnë të drejtat e njeriut dhe që u përmbahen standardeve të pranuar ndërkombëtarisht dhe praktikave më të mira evropiane;

*Duke e ripohuar* zotimin e tyre të përbashkët për të punuar në kuadër të kornizës së përgjithshme të politikave të BE-së të përcaktuara në Procesin e Stabilizimit dhe Asociimit me Kosovën;

*Duke e ripohuar* gatishmërinë për t'i kontribuar normalizimit të marrëdhënieve mes Prishtinës dhe Beogradit dhe për të përparuar me zbatimin e marrëveshjeve të bëra deri më tani gjatë dialogut të lehtësuar nga BE-ja si dhe të gjitha marrëveshjeve të tjera të ardhshme nga fusha e sundimit të ligjit;

*Duke e pasur parasysh* përputhshmërinë e plotë të programeve të asistencës së Bashkimit Evropian për Kosovën me objektivat e përgjithshme, synimet konkrete dhe aktivitetet specifike të parapara në këtë *Marrëveshje Kompakte*;

### **pajtohen si në vijim:**

1. Institucionet e Kosovës, të ndihmuara nga Bashkimi Evropian, *mes tjerash* edhe nga EULEX Kosova dhe me anë të projekteve nga Instrumenti i Para-Anëtarësimit (IPA) i PSBE-së dhe programet përcjellëse për mbështetje, e përsërisin zotimin e tyre për këto

### **Objektiva të përbashkëta të përgjithshme në fushën e sundimit të ligjit:**

- 1.) Fuqizimi i policisë, doganës dhe institucioneve korrektuese e gjyqësore në mbarë territorin e Kosovës, për të mirën e të gjitha komuniteteve, dhe sigurimi i qëndrueshmërisë së këtyre institucioneve në trajtimin e përgjegjësive të tyre;
- 2.) Rritja e kapaciteteve të institucioneve kosovare për sundimin e ligjit për trajtimin e krimeve ndëretnike, krimeve të rënda dhe të organizuara dhe të korrupsionit, në veçanti përmes sistemit të drejtësisë penale;

- 3.) Ngritja e llogaridhënies së të gjitha institucioneve për sundimin e ligjit duke i zhvilluar më tej kapacitetet dhe kompetencën e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Inspektoratit Policor të Kosovës, si dhe të strukturave të tjera përkatëse të brendshme që t'i marrin përsipër në tërësi rolet e tyre në përputhje me ligjin;
  - 4.) Konsolidimi i kapaciteteve menaxhuese strategjike, operative dhe organizative të institucioneve kosovare për sundimin e ligjit në drejtim të avancimit të zbatimit të legjislacionit, strategjive dhe planeve përkatëse të veprimit si dhe përmirësimit të mëtejshëm të ligjeve që kanë të bëjnë me sundimin e ligjit në Kosovë;
  - 5.) Inkurajimi i shkallës më të lartë të përfshirjes etnike dhe barazisë gjinore në institucionet kosovare për sundimin e ligjit;
  - 6.) Përmirësimi i reagimit të institucioneve kosovare për sundimin e ligjit ndaj shqetësimeve të ngritura shpesh nga ana e pakicave në lidhje me sigurinë publike, qasjen dhe transparencën;
  - 7.) Fuqizimi i bashkëpunimit ndërinstitucional ndërmjet organeve të prokurorisë dhe atyre për zbatimin e ligjit, duke e mundur një nivel më të lartë të komunikimit ndërmjet këtyre institucioneve;
  - 8.) Ngritja e kapaciteteve të institucioneve përkatëse për trajtimin e kërkesave pronësore të pazgjdhura;
  - 9.) Zhvillimi i mëtejshëm i sistemit të Kosovës për mbrojtjen e dëshmitarëve; përtej Udhërrëfyesit të zbatuar;
  - 10.) Fuqizimi i kapaciteteve të Prokurorisë Speciale të Kosovës (PSRK-së) për t'i ndjekur krimet e luftës;
  - 11.) Avancimi i shërbimeve mjeko-ligjore në Kosovë dhe fuqizimi i kapaciteteve të Institutit të Mjekësisë Ligjore si një agjenci e pavarur;
  - 12.) Zbatimi i marrëveshjeve të arritura në kuadër të dialogut të lehtësuar nga BE-ja, përfshirë shfrytëzimin e zyrës së PSBE-së për lehtësimin e kërkesave për ndihmë juridike reciproke.
2. Palët nënshkruese do të punojnë në bazë të Veprimeve dhe Udhërrëfyesve të Marrëveshjes Kompakte duke u fokusuar në fushat prioritare të identifikuara, të cilat i përcaktojnë aktivitetet



specifike dhe synimet konkrete me rezultate të matshme në përputhje me objektivat e përgjithshme të përbashkëta në fushën e sundimit të ligjit.

3. Si pjesë e përpjekjeve për përmbushjen e këtyre objektivave të përgjithshme të përbashkëta në fushën e sundimit të ligjit, Shefja e Zyrës së BE-së në Kosovë/PSBE-ja, Shefja e Misionit EULEX Kosova, Ministria e Drejtësisë, Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës zotohen që të takohen rregullisht në Bordin e Përbashkët Bashkërendues për Sundimin e Ligjit për ta shqyrtuar përparimin e arritur dhe për të rënë dakord për veprime konstruktive, praktike dhe të bashkërenduara për zgjidhjen e pengesave dhe avancimin e çështjeve teknike, përfshirë në fushat prioritare si në vijim:

- i) Zbatimin e veprimeve/udhërrëfyesit nga Marrëveshja Kompakte;
- ii) Kushtet e mbetura që kanë të bëjnë me liberalizimin e vizave të theksuara në Raportin e katërt të Komisionit Evropian të datës 4 maj 2016 për progresin e Kosovës në përmbushjen e kushteve për udhërrëfyesin për liberalizimin e vizave;
- iii) Legjislacionin lidhur me sundimin e ligjit;
- iv) Vazhdimësinë e ofrimit të shërbimeve në fushën e sundimit të ligjit përtej mandatit aktual të EULEX-it;
- v) Prioritetet e reformave të renditura në rishikimin e sektorit të sundimit të ligjit në Kosovë.

4. Institucionet kosovare, PSBE-ja/Zyra e BE-së dhe EULEX Kosova e ritheksojnë zotimin e tyre të fuqishëm për tejkalimin e mangësive të identifikuara, për caktimin e burimeve të nevojshme dhe për përqendrimin e punës së tyre drejt përmbushjes së objektivave të përgjithshme të përbashkëta nga fusha e sundimit të ligjit që janë përcaktuar në këtë Marrëveshje Kompakte.

**Prishtinë, 7 dhjetor 2016**

# POLICIA & DOGANANA



## POLICIA E KOSOVËS

PK, në përgjithësi ka vazhduar me një nivel të pranueshëm të qëndrueshmërisë dhe llogaridhënies gjatë ofrimit të shërbimeve policore. Ajo i ka krijuar sistemet, proceset dhe procedurat standarde të operimit të brendshëm që i mundësojnë një kuadri të operacioneve që të ofrojnë standardet minimale që priten nga një shërbim policor. Ndërkohë, ende ekzistojnë disa mangësi strukturore, veçanërisht në mbajtjen e numrit të mjaftueshëm të personelit të trajnuar për fusha tematike dhe në sigurimin e nivelit të standardizuar të pajisjeve në disa fusha të operimit. PK-ja në veri të Kosovës është ballafaquar me një numër të çështjeve, veçanërisht në menaxhimin dhe drejtimin strategjik të policimit në këtë rajon. Gjatë mandatit 2016-2018, këshilltarët policorë të EULEX-it kanë vazhduar t'i mbështesin drejtuesit më të lartë të PK-së në zhvillimin e kapaciteteve si dhe për identifikimin dhe adresimin e mangësive strukturore dhe sistematike.

### POLICIA NË KOMUNITET

Policia në komunitet ka mbështetje dhe përkushtim adekuat në të gjitha radhët e PK-së. Zbatimi i dokumentit kryesor drejtues në këtë fushë, *Strategjia e PK-së për Policinë në Komunitet dhe Plani i Veprimit 2017-2021* e kanë bërë PK-në më të angazhuar në

*Policia në komunitet është strategji policore që përqendrohet në ndërtimin e lidhjeve nga ana e policisë me komunitetet e tyre si dhe në adresimin e shqetësimeve të sigurisë publike duke bashkëpunuar në mënyrë proaktive dhe të ngushtë me ta. Aty përfshihen funksionet themelore policore të parandalimit të krimeve, hetimet, rendi dhe qetësia publike dhe operacionet e sigurisë.*

komunitetet të cilave ajo u shërben. Në korrik të vitit 2017, PK-ja e ka rishqyrtuar periudhën e parë gjashtë mujore të këtij dokumenti, e cila ka zbuluar se është bërë progres në zbatimin e Planit të veprimit. Dy të arritura të dukshme në këtë drejtim ishin organizimi i 180 forumeve të sigurisë në tërë Kosovën si dhe rishikimi dhe ndryshimi i Procedurave Standarde të Operimit lidhur me këtë strategji. Gjatë rishikimit të dytë në dhjetor të vitit 2017, pjesëmarrësit kanë vlerësuar se 18 prej 20 detyrave të PK-së ishin realizuar, duke treguar kështu një përkushtim të fuqishëm dhe progres të mirë në zbatimin e kësaj strategjie. Emërimi i kreut të ri të policisë në komunitet gjithashtu ka ndihmuar në përmirësimin e policisë në komunitet në Drejtorinë Qendrore të PK-së.

Ndërsa vlerësohet progresi i bërë nga PK-ja në miratimin dhe zbatimin e qasjes së policisë në komunitet, ende mbeten disa sfida. Drejtoria Qendrore e PK-së përgjegjëse për përmbushjen e strategjisë së policisë në komunitet mund të menaxhojë dhe ngarkojë me detyra vetëm koordinatorët rajonalë të policisë në komunitet përmes zinxhirit komandues nëpër regjione; prandaj, lidhja prej stacioneve të PK-së të nivelit qendror me ato të nivelit lokal mbetet e dobët. Për më shumë, përveç takimeve gjashtëmujore për shqyrtimin e progresit nuk ka takime tjera për koordinim me menaxhmentin e lartë për mbikëqyrjen e zbatimit të strategjisë së policisë në komunitet dhe asnjë përpjekje për ta vlerësuar zhvillimin institucional të policisë në komunitet.

Zbatimi i plotë dhe efektiv i Planit të Veprimit të policisë në komunitet kërkon fonde shtesë për pajisje dhe automjete si dhe shtim të personelit që punon në nivel të stacionit. Po ashtu, duhen bërë përpjekje të mëtejme për ta arritur një përfaqësim më të mirë gjinor dhe etnik në mesin e oficerëve të PK-së, meqë shërbimi policor i bazuar në komunitet duhet ta pasqyrojë komunitetin të cilit ai i shërben. Numri i oficerëve femra të PK-së është nën mesataren e BE-së, kurse pakicat e Kosovës nuk janë të përfaqësuara në mënyrë adekuate në PK.

## **FUNKSIONIMI I POLICISË NË BAZË TË ANALIZAVE DHE TË DHËNAVE**

Metodologjia e funksionimit të PK-së në bazë të analizave dhe të dhënave (FPADH) ende është në fazat e hershme të saj dhe ende nuk ofron një strukturë për vendimmarrje në bazë të informacioneve dhe të kontrollueshme. PK-ja si institucion ende nuk i ka kuptuar dobitë e mundshme të FPADH. Kjo gjë vërehet në tërë organizatën ku komandantët regionalë dhe të stacioneve rregullisht i kanë orientuar oficerët e FPADH në detyra operative tjera. Si rezultat i kësaj ndarjeje të resurseve, efektiviteti i FPADH në PK është zvogëluar dukshëm. Në tetor të vitit 2017, EULEX-i i ka dhënë PK-së një grup të rekomandimeve, duke i theksuar çështjet e ndarjes së resurseve, numrin e vogël të paraqitjes së informatave dhe nevojën për një proces më të strukturuar të caktimit të detyrave dhe koordinimit. PK-ja i ka pranuar rekomandimet dhe është përkushtuar që të punojë për zbatimin e tyre si një pilot-iniciativë në dy regjione të policisë.

Procesi i caktimit të detyrave dhe koordinimit është pjesë e rëndësishme e metodologjisë FPADH për identifikimin e çështjeve si tiparet e krimeve, vatrat e krimeve dhe kërkesat tjera nga shërbimi policor. Këtu përfshihen kërkesat për shqyrtimin e resurseve për të siguruar ndarje të duhur dhe efektive të resurseve në nivelin operativ. Duke filluar në nëntor 2017, EULEX-i i ka monitoruar takimet e Grupit për Detyra dhe Koordinim në regjionet e policisë në Mitrovica Jug dhe Ferizaj, ku PK ka qenë konsekuente në mbajtjen e këtyre takimeve si dhe e ka mirëpritur kërkesën për përmirësimin e cilësisë së tyre. Si rezultat i këtij monitorimi, EULEX-i ka dhënë sugjerime për mënyrat e përmirësimit të efikasitetit. Ndërkohë, Drejtoria për Inteligjencë dhe Analizë e PK-së është angazhuar me regjionet tjera për t'i iniciuar proceset e ngjashme të Grupit për Detyra dhe Koordinim.

Sistemi Informativ i Policisë së Kosovës – një paketë e softuerit policor të avancuar multifunksional – është instrument përbërës për zbatimin e suksesshëm të FPADH pasi që është shumë i rëndësishëm për mbledhjen, regjistrimin dhe analizimin e informacioneve i cili prodhon analiza të përdorshme dhe efektive. Ky sistem është krijuar në vitin 2010 dhe kryesisht është përdorë për ofrimin e raporteve për incidentet, të dhënat statistikore dhe veprimtarive kriminale brenda ndonjë regjioni të caktuar. Nga aspekti operativ, vetëm disa funksione të caktuara të këtij sistemi janë shfrytëzuar përkundër asaj se PK-ja dalëngadalë e ka zhvilluar dhe shtuar shfrytëzimin e këtij sistemi për të përfshirë integrimin e sistemeve të analizës/inteligjencës dhe sistemeve të gjykatës. Pasi që shumica e raporteve të inteligjencës të PK-së futen në bazën e të dhënave e cila nuk është e lidhur me Sistemin Informativ të Policisë së Kosovës, mundësia për shkëmbimin e informacioneve dhe potenciali për harmonizimin e mbledhjes së të dhënave të rëndësishme për vendimmarrje janë të kufizuara. Interoperabiliteti i sistemeve informatike në të gjitha institucionet e drejtësisë penale të Kosovës, duke e përfshirë PK-në, vijon të jetë një sfidë e konsiderueshme.

*FPADH është një qasje për zgjidhjen e krimeve, ku në mënyrë analitike të deshifrohen të dhënat kriminale për të përcaktuar resurset që duhet të shfrytëzohen për ta frenuar dhe eliminuar krimin.*

## **DHUNA SEKSUALE DHE NË BAZË GJINORE**

Institucionet e Kosovës përgjatë një numri të viteve e kanë ndërtuar një kornizë ligjore dhe të politikave që e ka potencialin të ofrojë mbrojtje për ata që janë më të cenueshmit nga dhuna seksuale dhe në bazë gjinore. Qeveria ka bërë progres të vogël në përmirësimin e mekanizmave institucionalë të tij për t'u ndihmuar viktimave të këtyre veprave, veçanërisht në fuqizimin e qasjes së partneritetit ndërmjet policisë dhe prokurorisë. Një dokument i rëndësishëm për luftimin e dhunës familjare është *Strategjia kombëtare për mbrojtjen nga dhuna familjare dhe Plani i veprimit 2016-2018*. Aty përcaktohen veprimet e hollësishme që duhen ndërmarrë për t'i përmirësuar kapacitetet dhe mundësitë e institucioneve përgjegjëse për parandalimin, zbulimin dhe ndjekjen penale të rasteve të dhunës familjare si dhe për përkrahjen e viktimave. Në muajin shkurt 2018, Qeveria e ka emëruar Koordinatorin Kombëtar kundër Dhunës Familjare për ta mbikëqyrur zbatimin e këtyre politikave, aktiviteteve dhe veprimeve të përcaktuara nga *Strategjia kombëtare dhe Plani i veprimit*.

Gjatë vitit, PK-ja i ka përmirësuar kapacitetet hetimore të saj. Janë organizuar programe të ndryshme trajnimi me aktorë të jashtëm që janë përqendruar në fuqizimin e teknikave të PK-së për intervistim kur kanë të bëjnë me viktimat. Në prill të vitit 2018, një ekspert nga Britania e Madhe e ka mbajtur një kurs për PK-në për "trajnimin e trajnerëve" lidhur me modelet njohëse të intervistimit, i cili ndihmon në marrjen e dëshmimeve të cilësisë më të mirë dhe promovon qasjen hetimore me viktimën në qendër. Për më shumë, në shkurt të vitit 2018, Byroja Federale e Hetimeve e SHBA-ve (FBI-ja) e ka mbajtur një punëtor për intervistimin forenzik të fëmijëve të veprave të dhunës seksuale dhe në bazë gjinore. Të dyja kurset kanë qenë të integruara në planprogramin e Akademisë Kosovare për Siguri Publike për

mësimdhënie të mëtejme – një hap pozitiv përpara ky për PK-në që të arrijë kapacitete të qëndrueshme në hetimin e veprave me ndjeshmëri gjinore. Një hap tjetër pozitiv ka qenë krijimi i grupit punues forenzik polici-prokurori në mars 2018: qëllimi i tij ishte që ta përgatisë një dokument procedural gjithë-institucional për ta inkurajuar mbledhjen më efektive të dëshmimeve forenzike, me çka do të ndihmohej në ndjekjen penale të incidenteve të dhunës seksuale dhe në bazë gjinore.

Përkundër përpjekjeve për ta orientuar bashkëpunimin ndërmjet agjencive dhe fuqizimin e aftësive të personelit, ende ekzistojnë disa sfida të konsiderueshme. Në kundërshtim me këshillën e EULEX-it, Njësia për Politika për Dhunën Familjare e PK-së ka mbetur në kuadër të Departamentit të Policisë në Komunitet në vend të Departamentit të Hetimeve, derisa Njësia për Dhunën Familjare që parashihet të plotësohet me hetues që do të merreshin vetëm me këto raste ende nuk është krijuar. Ende ka mungesë të policëve me aftësi, përvojë dhe kapacitet për t'u angazhuar në mënyrë efektive në qasjen hetimore me viktimën në qendër, e cila është kriter bazë gjatë trajtimit të këtyre llojeve të veprave. Gjithashtu, policët reagues duhet pajisur me aftësitë e domosdoshme për të siguruar që proceset e ankesës së parë të trajtohen me dhembshuri por në mënyrë profesionale, duke iu përmbajtur parimit të dëshmisë më të mirë.

## **NJËSITË E SPECIALIZUARA DHE EKIPET PËR REAGIM TË SHPEJTË**

Shumica e Njësive të Specializuara të PK-së janë duke iu afruar një standardi të operimeve në nivel të njësive të ngjashme në vendet e Bashkimit Evropian. Ato kanë vazhduar të demonstrojnë performancë të mirë në shumicën dërmuese të operacioneve, si kontrollin e turmave dhe trazirave, operacionet e rendit dhe qetësisë publike, siguria për VIP

dhe operacionet speciale policore. Megjithatë, performanca e Njesisë Speciale Intervenuese, nënënjësi e cila shpeshherë angazhohet në operacionet me rrezikshmëri të lartë, nuk ka treguar nivelin e kërkuar të kompetencës në fushën e saj të operimeve, e cila është vërtetuar gjatë arrestimit të Drejtorit të Zyrës së Serbisë për Kosovë e Metohi në mars të vitit 2018. Ky arrestim ka vënë në pah mangësitë në punën e kësaj njësie, duke përfshirë mungesën e profesionalizmit dhe të kuptuarit jo të mirë të *doktrinë së përdorimit të forcës*, çka ka treguar domosdoshmërinë për përmirësimin e performancës së tyre gjatë realizimit të operacioneve.

Përkundër performancës së përgjithshme të fortë të tij, Divizioni i Njësive të Specializuara të PK-së ka vazhduar të ndër marrë hapa të mëtejme për fuqizimin e kapaciteteve të tij. Në dhjetor të vitit 2017, ky Divizion e ka krijuar një grup punues për ta kryer një rishikim të thellë të Manualit të tij për Kontrollin e Turmave dhe Trazirave. Duke qenë se Kosova gjatë viteve të kaluara është pranuar si anëtare e disa organizatave sportive ndërkombëtare, EULEX-i e ka përqendruar mbështetjen e tij në pjesën e Manualit për punën policore gjatë ngjarjeve të mëdha. Ndërkohë, në nivelin operacional, PK-ja duhet që t'i mbyllë zbrazëtitë në ofrimin e mbështetjes për ngjarjet ndërkombëtare të futbollit, pasi që nuk ka përvojë dhe njohuri për bërjen e planeve rezervë për këto lloje të ngjarjeve.

Në prill të vitit 2018, EULEX-i e ka organizuar një trajnim për oficerët e lartë të PK-së për t'i ofruar komandës së PK-së mundësi për t'i përmirësuar aftësitë dhe ekspertizën aktuale të tyre gjatë ballafaqimit me ngjarje spontane dhe të planifikuara më përpara për të cilat kërkohen plane rezervë të mbajtjes së rendit dhe sigurisë publike. Ndonëse PK-ja i ka zhvilluar aftësitë dhe ekspertizën për t'u ballafaquar me ngjarjet spontane dhe të planifikuara më përpara për të

cilat kërkohet reagim për kontrollimin e turmave dhe trazirave, ky institucion duhet që t'i zhvillojë më tej mundësitë e tij për t'u ballafaquar me kërcënimet ndaj sigurisë publike, siç janë pajisjet eksplozive të improvizuara që barten në trup, qitësit aktivë dhe shfrytëzimi i automjeteve në vendet me shumë njerëz.

Një çështje kryesore që ka mbetur e pazgjidhur në vitin e kaluar është zhvendosja e papërfunduar e Njësive të Specializuara në kampin që më përpara është shfrytëzuar nga Forcat Portugeze në Kosovë (KFOR-i). Megjithëse KFOR-i e ka liruar kampin në vitin 2016, zhvendosja e Njësive të Specializuara prej kampit të tanishëm të tyre afër Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës në kampin ushtarak që ndodhet në qendër të Prishtinës ende nuk është përfunduar. Kjo do ta zvogëlojë kohën e reagimit nga Njësitë e Specializuara, sidomos në rastet e incidenteve të rënda.

Gjatë vitit të kaluar, PK-ja nuk ka bërë progres në adresimin e mangësive në drejtimin dhe pajisjet e Ekipeve për Reagim të Shpejtë. Njësitë për Reagim të Shpejtë janë një formacion i dytë i njësive për intervenim që ndodhen në Drejtorinë Regjionale të Policisë në tërë Kosovën. Një vlerësim i kryer nga EULEX-i në vitin 2017 ka gjetur mangësi shumë të mëdha në drejtimin dhe pajisjet e këtyre njësive. Ky vlerësim ka zbuluar se këto ekipe shpeshherë ngarkohen me detyra jashtë fushëveprimit të paraparë të punës së tyre, kurse në disa regjione atyre u mungojnë edhe pajisjet elementare. Në ndërkohë, disa komandantëve të caktuar në këto njësi u mungojnë aftësitë drejtuese dhe teknike të domosdoshme për ato pozita.

## **POLICIA E KOSOVËS NË VERI TË KOSOVËS**

Zinxhiri i drejtësisë në veri të Kosovës është kompletuar formalisht në tetor të vitit 2017, kur 40 gjyqtarë serbë të Kosovës dhe 13 prokurorë serbë të Kosovës i janë bashkuar sistemit të drejtësisë së Kosovës. Që prej mbylljes së gjykatës të administruar nga Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë në vitin 2008, popullata në veri të Kosovës ka pasur qasje të kufizuar në drejtësi, që për pasojë ia ka zvogëluar mundësinë PK-së që ta zbatojë ligjin. Prandaj, zbatimi i Marrëveshjes për Drejtësinë të lehtësuar nga BE-ja ka qenë shumë i rëndësishëm për t'ia krijuar PK-së në veri të Kosovës kushtet e domosdoshme për tu zhvilluar në një shërbim policor funksional. Deri sa gjykata ka ndërmarrë hapa për t'u bërë plotësisht funksionale, edhe kërkesat janë shtuar sa i përket punës së PK-së në veri të Kosovës.

Mungesa e gjyqësorit funksional në veri të Kosovës gjatë dekadës së kaluar ka krijuar numër prej mijëra lëndëve të grumbulluara, që presin të përcillen nga PK-ja tek Prokuroria Regjionale (numri i saktë nuk dihet, meqë policia nuk ka mbajtur të dhëna statistikore të besueshme). Si hap i parë, PK-ja ka kontaktuar me Kryeprokurorin Regjional në nëntor të vitit 2017 për ta filluar procesin e dorëzimit të lëndëve. EULEX-i e ka këshilluar PK-në që ta bëjë prioritet dorëzimin e rasteve të mundshme të motivuara etnikisht që kanë ndodhur shpeshherë në veri të Mitrovicës nga muaji shkurt i vitit 2017. Megjithatë, dorëzimi ka nisur ngadalë, pasi që Kryeprokurori Regjional ishte i gatshëm që t'i pranonte vetëm nga 10 raste për çdo javë – dhe këto ishin raste ku diheshin kryerësit e tyre.

Hetimi i vrasjes së profilit të lartë të Oliver Ivanoviqit, politikan serb i Kosovës i vrarë në veri të Mitrovicës në janar 2018, u bë sfidë tjetër e konsiderueshme për PK-në në veri të Kosovës. Veprimet e PK-së duke iu përgjigjur

dhe duke e hetuar pastaj këtë vrasje kanë zbuluar një numër të mangësive institucionale të PK-së në veri. Njësisë së Hetimeve Regjionale të PK-së shihej që i mungonin sistemet dhe proceset e mirëfillta për hetimin e veprave të rënda, që u vërtetua nga mungesa e një strategjie të qartë për hetime apo caktimin e prioritetit për veprimet hetimore. Në anën tjetër, gjatë zhvillimit të hetimeve, policët e PK-së gjithashtu shfaqën një hezitim të përgjithshëm për të ndjekur disa vija të caktuara të veprimeve hetimore. Ky rast është transferuar në Departamentin e Hetimeve të PK-së në Prishtinë në mars të vitit 2018. Prej atëherë, hetuesit nga Mitrovica Veriu kanë pasur rol të kufizuar në këto hetime, i cili kryesisht ka qenë që të përgjigjen në kërkesat e caktuara. Puna e PK-së në këto hetime tregon se shërbimi policor në veri ende ka probleme të konsiderueshme të cilat duhet të adresohen.

Në nëntor të vitit 2017, EULEX-i e ka kryer një analizë të pikave statike patrulluese të PK-së në veri për të përcaktuar nëse janë duke u shfrytëzuar si duhet resurset policore. Stacioni Mitrovica Veriu doli të jetë më problematiku në këtë aspekt, ku 68 prej 78 oficerëve të PK-së ishin caktuar në pika statike, rrjedhimisht mbetej vetëm një njësi në dispozicion gjatë ndërrimit për gjithë patrullimin e rregullt. Në mars të vitit 2018, në përputhje me

*Si rezultat i Marrëveshjes së Brukselit të vitit 2013, është krijuar një Drejtori Regjionale e veçantë e Policisë në veri të Kosovës, duke i vendosur nën komandën e drejtpërdrejtë të saj stacionet lokale të policisë në katër komunat me shumicë serbe në veri të Kosovës. Në ndërkohë, edhe 286 ish-pjesëtarë tjerë të MUP-it (Ministrisë së Brendshme të Serbisë) janë integruar në forcën e PK-së që funksionon në këto komuna. Drejtorja Regjionale e Policisë Mitrovica Veriu është funksionalizuar në mars 2014 dhe prej atëherë është mbështetur vazhdimisht në mënyrë të strukturuar nga këshilltarët policorë të EULEX-it përmes mentorimit, monitorimit dhe këshillimit.*



rekomandimet e EULEX-it, Komanda Regionale e PK-së i ka dërguar kërkesë formale Drejtorisë Qendrore të PK-së për ta bërë një vlerësim të ri të rrezikut në të gjitha lokacionet e patrullave statike. Si përgjigje ndaj kësaj është larguar vetëm një pikë statike, kurse Drejtoria e Përgjithshme e PK-së nuk e ka kryer vlerësimin e ri të rrezikut.

Në përgjithësi, ekipit drejtues të Regionit Veriu të PK-së ende i mungon një qasje sistematike

për vendimmarrje të bazuar dhe dokumentuar, duke e shfrytëzuar pak apo pothuaj aspak analizën dhe vlerësimin e rrezikut, me çka sigurohen informatat dhe mbrohet procesi i vendimmarrjes që mundëson shfrytëzim efektiv të resurseve. Ka pak dëshmi që flasin për mundësinë e PK-së për t'i shqyrtuar çështjet strategjike të regjionit, ose për të zhvilluar strategji me qasje policore për zgjidhjen e problemeve.

**RRUGA PËRPARA:** Duke marrë parasysh se PK-ja ka arritur nivel të pranueshëm të funksionimit duke ofruar shërbime policore që janë të krahasueshme me atë të homologëve të saj në gjithë rajonin, EULEX-i e ka ndërprerë mbështetjen këshillëdhënëse policore të tij për PK-në në fund të mandatit paraprak të tij më 14 qershor të vitit 2018. Megjithatë, kjo organizatë ende përballlet me një numër të sfidave strategjike që janë theksuar në këtë raport. Prandaj, Zyra e BE-së do të vazhdojë ta mbështesë nivelin e drejtuesve të lartë të PK-së me anë të një roli këshillëdhënëses më të vogël. Për më shumë, një projekt 40-mujor i IPA-s që synon ta mbështesë PK-në në reformimin e strukturës organizative dhe funksionale të saj parashihet të fillojë në vjeshtën e vitit 2018.





## INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS

Gjatë periudhës që e mbulon ky raport, IPK-ja është ballafaquar me një numër të sfidave serioze të brendshme si dhe me keqmenaxhim: të gjitha këto kanë ndikuar seriozisht në funksionalitetin e tij.

*IPK është agjenci ekzekutive e krijuar në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Ai është i pavarur nga PK-ja dhe ka për detyrë që të sigurojë një shërbim policor të përgjegjshëm, demokratik dhe transparent. IPK i heton zyrtarët e PK-së të cilët dyshohen se janë përfshirë në vepra penale ose incidente disiplinore të profilit të lartë. Inspektorati policor funksional është shumë i rëndësishëm për llogaridhënien policore në Kosovë.*

Përkundër rritjes së buxhetit të tij për vitin 2017, IPK-ja nuk ka punësuar personel shtesë për ta mbuluar mungesën e personelit prej 20%. Pasi ishte kryer procesi i rekrutimit, një grup i paditësve kanë ngritur padi kundër Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe IPK-së, duke pretenduar parregullsi në këtë proces. Pas hetimeve, është vërejtur një numër i parregullsive dhe kontratat e 16 të punësuarve të ri janë anuluar në janar të vitit 2018. Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së është suspenduar gjatë muajit pasues pasi që dyshohej se ai ishte përpjekur të ndikonte në kryesuesin e komisionit përzgjedhës për këto 16 pozita – në fund për këtë Ministri i Punëve të Brendshme e ka shkarkuar në muajin qershor. Edhe puna e personelit tjetër të lartë të IPK-së është vënë në pikëpyetje gjatë hetimit të një asti të korrupsionit kundër Drejtorit të Krimeve

Ekonomike të PK-së. Prandaj, në shkurt të vitit 2018, U.D. i Kryeshefit Ekzekutiv të IPK-së i ka pezulluar dy Drejtor të Hetimeve të IPK-së, të cilët dyshoheshin se i kishin shtrembëruar provat gjatë këtij hetimi. Për shkak të këtyre dhe zhvillimeve tjera në kuadër të IPK-së, Ministri i Punëve të Brendshme u thirr në Komisionin Parlamentar për Punë të Brendshme dhe Siguri që të raportonte lidhur me pretendimet për keqmenaxhim në këtë institucion. Komisioni vendosi që ta krijonte një Komision Hetimor për ta monitoruar zbatimin e *Ligjit për Inspektoratin Policor të Kosovës*.

Funksionaliteti i IPK-së është ndikuar gjithashtu nga bashkëpunimi i dobët ndërinstytucional me policinë, prokurorinë dhe gjyqësorin. Bashkëpunimi ndërmjet IPK-së dhe prokurorisë ende kërkon përmirësim të mëtejshëm pasi rastet e hetuara nga IPK-ja nuk kanë pasur prioritetin e mjaftueshëm, hetimet kanë mbetur tejet të gjata, kurse IPK-ja nuk është informuar lidhur me vendimet përfundimtare të nxjerra nga gjykatat. Lidhjet institucionale ndërmjet IPK-së dhe PK-së po ashtu kanë mbetur të dobëta dhe sfiduese. Nevojitet një bashkëpunim më i mirë ndërmjet IPK-së dhe Departamentit të Standardeve Profesionale të PK-së për ta filluar praktikën e shkëmbimit të numrave të rasteve dhe krijimit të një mekanizmi të përcjelljes sa i përket oficerëve të policisë që i janë nënshtruar masave disiplinore.

**RRUGA PËRPARA:** Krahas këshilltarëve të tij në PK, EULEX-i i ka tërhequr gjithashtu këshilltarët e tij nga IPK-ja në fund të mandatit paraprak të tij më 14 qershor të vitit 2018. Duke i marrë parasysh mangësitë institucionale të konsiderueshme që mbeten në IPK, aktorët e tjerë ndërkombëtarë do të vazhdojnë të angazhohen për mbështetjen e zhvillimit të mëtejshëm të këtij institucioni.

## DOGANA E KOSOVËS DHE POLICIA KUFITARE E KOSOVËS

Dogana e Kosovës ka arritur një sukses tjetër të dukshëm lidhur me arkëtimin e të hyrave në 2017, duke e tejkaluar me 13 milionë € ose 1.2% synimin ambicioz të saj për arkëtimin vjetor. Arkëtimi i të hyrave në vitin 2017 është rritur për 7% ose 70 milionë € krahasuar me vitin 2016, ndërsa trendi ka qëndruar pozitiv edhe gjatë gjysmës së parë të vitit 2018. Ky është një rezultat veçanërisht i dukshëm kur kemi parasysh ndikimin negativ të cilin e ka pasur zbatimi i Marrëveshjes për Stabilizim Asocim në nivelin e arkëtimin të të hyrave, duke shkaktuar një humbje të përgjithshme prej 30 milionë € në vitin 2017 dhe 25 milionë € tjera nga pakoja fiskale e qeverisë që përfshin lirimet nga detyrimet dhe taksat. Një nga aspektet më pozitive të arkëtimin të hyrave nga Dogana e Kosovës për vitin 2017 ka qenë se shkalla e deklarimit nga kompanitë ka arritur nivelin më të lartë të të gjitha kohëve prej 97-98%, deri sa numri i ankesave ka rënë dukshëm. Përveç kësaj, Dogana e Kosovës ka raportuar rezultate pozitive në zbatimin e ligjit gjatë vitit 2017, në veçanti për shkeljet e të drejtave mbi pronën intelektuale, kumarit të kundërligjshëm, kontrolleve kundër kontrabandës dhe luftimit të ekonomisë joformale. Sa i përket shkeljes së të drejtave mbi pronën intelektuale, rezultatet kanë qenë mbi 100% më të larta krahasuar me vitin 2016 në kapjen e mallrave të falsifikuara, kurse aksionet kundër kumarit të kundërligjshëm janë rritur për 67%, dhe kundër kontrabandës me 65%, duke përfshirë 38 raste të kapjes së armëve dhe municioneve, 54 raste të kapjes së narkotikëve, dhe kapjes së valutave të falsifikuara në vlerë prej më shumë se 2 milionë €. Gjatë tërë vitit, EULEX-i ka vazhduar bashkëpunimin e ngushtë me drejtuesit e lartë të Doganës së Kosovës, duke ofruar këshilla për procesin e vazhdueshëm të reformës së administratës, përfshirë për përmirësimin e deklarimit dhe zbatimit të ligjit si dhe përmirësimin e procedurave për arkëtim më

efektiv të të hyrave në përputhje me ligjet e BE-së.

Në fushën e kontrollit dhe menaxhimit të kufirit, zbatimi i Strategjisë Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Kufirit (MIK-në) dhe Planit të Veprimit nuk ka ecur përpara me shpejtësinë e dëshiruar. Me vonimin e formimit të qeverisë së re në shtator të vitit 2017 dhe me ndërrimin e mëvonshëm të Ministrit të Punëve të Brendshme, pozita e Koordinatorit Kombëtar për MIK që normalisht e zinte Zëvendësministri i Punëve të Brendshme, ka mbetur e paplotësuar për një kohë të gjatë. Kjo gjë ka krijuar zbrazëti në zbatimin e Strategjisë për MIK dhe Planit të Veprimit, prandaj ka ndikuar negativisht në zhvillimin në proces të Qendrës Kombëtare për Menaxhimin e Kufirit. Megjithatë, në qershor të vitit 2018, Ministri i ri i Punëve të Brendshme e ka emëruar Koordinatorin Kombëtar të ri për MIK. Gjithashtu, ministri e ka shprehur përkushtimin e tij për zbatimin e MIK-ut me anë të hartimit të *Strategjisë Kombëtare për MIK dhe Planin e Veprimit 2018-2023*, si dhe duke e bërë plotësisht funksionale Qendrën Kombëtare për Menaxhimin e Kufirit.

Bashkëpunimi operacional ndërmjet Policisë Kufitare të Kosovës dhe Agjencisë Evropiane për Mbrojtjen e Kufirit dhe Bregdetit (FRONTEX) ka filluar në vitin 2017, duke i mundësuar Policisë Kufitare të Kosovës që të marrë pjesë në trajnimet e FRONTEX-it, shkëmbimin e rregullt të informacioneve dhe produkteve analitike në fushat e vlerësimit të kërcënimeve, analizës së rreziqeve dhe raportet mbi situatën. Ky bashkëpunim ka vazhduar në vitin 2018, kur oficerët e Policisë Kufitare të Kosovës janë dërguar jashtë vendit si vëzhgues në operacionet e ndryshme të FRONTEX-it, si në kufirin tokësor të jashtëm të BE-së ashtu edhe në aeroportet ndërkombëtare të BE-së. Prej

muajit shkurt 2018, dy oficerë të FRONTEX-it janë dërguar edhe në kufirin Kosovë-Shqipëri

për t'i mbështetur autoritetet lokale.



**RRUGA PËRPARA:** Duke e pasur parasysh vazhdimin e performancës së fuqishme të Doganës së Kosovës dhe Policisë Kufitare të Kosovës, EULEX-i do ta ngushtojë mbështetjen e tij të monitorimit, mentorimit dhe këshillimit për këto institucione në vetëm për çështjet e lidhura me Dialogun. Në kuadër të mandatit të ri të tij, EULEX-i do t'i këshillojë Doganën e Kosovës dhe Policinë Kufitare të Kosovës për avancimin e zbatimit të Marrëveshjes nga ky Dialog për MIK-un dhe dokumenteve të ndërlidhura deri atëherë kur këto përgjegjësi të kalojnë tek ndonjë mekanizëm alternativ i BE-së, ndoshta PSBE-ja.

# DREJTËSIA





# MONITORIMI I RASTEVE TË PËRZGJEDHURA TË KOSOVËS

Gjatë periudhës të mbuluar në këtë raport, EULEX-i ka monitoruar mbi 200 raste të transferuara nga EULEX-i dhe 10 raste *ad hoc* në lidhje me të cilat janë paraqitur ankesa nga jashtë tek EULEX-i. Rastet janë monitoruar në shtatë gjykata themelore, atë të Prishtinës, Prizrenit, Mitrovicës, Ferizajt, Pejës, Gjilanit, Gjakovës, në disa degë të gjykatave dhe në Gjykatën e Apelit.

Gjendja nëpër gjykata nuk ka shënuar ndonjë ndryshim domethënës gjatë vitit të kaluar, dhe drejtësia vazhdon të ballafaqohet me një sërë sfidash dhe parregullsish, siç janë:

- Vonesat tek proceset gjyqësore, ku shkelen afatet procedurale dhe standardet për gjykime të drejta në aspektin e kohëzgjatjes së arsyeshme të procedurave;
- Regjistrat e pamirëmbajtur të gjykatave, ku lëndët e rasteve gjenden me vështirësi, që përbën shkelje të *Rregullores për Organizimin e Brendshëm të Gjykatave*;
- Infrastruktura dhe pajisjet e papërshtatshme nëpër gjykata, në veçanti në Gjykatën Themelore të Mitrovicës (GjThM);
- Bashkërendimi i dobët mes institucioneve kryesore për sundimin e ligjit;
- Praktika e vazhdueshme e gjyqtarëve që palëve të mos u japin vërejtje apo t'u shqiptojnë gjoba apo që të përdorin masa të tjera që parashihen në *Kodin e Procedurës Penale* kur procedurat e gjykatës nuk respektohen nga palët;
- Mungesa e identifikimit dhe ndjekjes penale të krimeve që potencialisht janë krime nga urrejtja;

- Mungesa e njohurive dhe trajnimeve për gjykimin e krimeve të luftës;
- Neglizhencë ndaj zbatimit të *Ligjit për përdorimin e gjuhëve*, gjë që prekë të drejtat e palëve që nuk flasin gjuhën shqipe.

Përmes monitorimit të tij, EULEX-i ka vazhduar t'i identifikojë mangësitë në procedurat juridike dhe t'i diskutojë ato në mënyrë të strukturuar me institucionet e vendit, KGJK-në dhe KPK-në. Mangësia e monitoruar e cila është më domethënësja ka të bëjë me vonesat tek procedurat penale. Një nga shkaqet kryesore të këtyre vonesave ishte se, mesatarisht, gjysma e seancave dëgjimore të monitoruara, pas fillimit janë shtyrë menjëherë për afat tjetër nga gjyqtarët. Kjo praktikë përbënë përdorim joefikas të burimeve gjyqësore duke mos i shtuar asgjë thelbit të gjykimit. Mesatarisht, rreth gjysma e të gjitha seancave dëgjimore të monitoruara janë shtyrë menjëherë për afate të tjera. Megjithatë, gjatë muajve të fundit të periudhës për të cilën raportohet, përqindja e seancave dëgjimore të shtyra ka shënuar një rënie të vogël. EULEX-i po ashtu ka vërejtur pak progres në caktimin e rasteve të vonuara të profileve të larta, siç janë rastet "Olympus I", "KEK" dhe "Tolaj".

*Raste të caktuara që nuk kanë qenë nën kompetencën e EULEX-it që nga viti 2014, apo të cilat janë konsideruar të jenë të ndjeshmërisë së kufizuar, janë bartur nga gjyqtarët dhe prokurorët e EULEX-it tek autoritetet e Kosovës. Me qëllim të mbështetjes së autoriteteve të Kosovës për ruajtjen e cilësisë së procedurave dhe natyrën e pavarur të drejtësisë, EULEX-it i është caktuar detyra për monitorimin e rasteve të përzgjedhura nëpër Kosovë.*

**RRUGA PËRPARA:** Gjatë mandatit të ri, EULEX-i do të vazhdojë të monitorojë raste duke u përqendruar në raste të profilit të lartë që Misioni i ka dorëzuar tek homologët vendas. Aktivitetet e monitorimit gjatë mandatit të ri do ta mbulojnë edhe hetimin e rasteve në nivel të policisë, përveç niveleve të prokurorisë dhe gjyqësorit.

## KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS

Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK-ja) ka treguar përmirësime të vazhdueshme tek performanca e vet në krahasim me vitin e kaluar. Drejtori i ri i Sekretariatit të KGJK-së më në fund e ka filluar punën në shtator të vitit 2017, nën udhëzimet e të cilit KGJK-ja aktivisht ka kontribuar në zbatimin e dy udhërrëfyesve të BPSL-së. Këta

*KGJK-ja është përgjegjëse për të siguruar sistem gjyqësor të pavarur, profesional dhe të paanshëm. KGJK-ja vepron e pavarur nga ekzekutivi – masë e ndërmarre për të siguruar pavarësinë e gjyqësorit. Ndonëse është bërë decentralizim i pjesshëm ku gjykatat kanë marrë kompetenca të reja menaxheriale, KGJK-ja është përgjegjëse për menaxhimin e tërë sistemit gjyqësor, që mbulon tërë drejtësinë civile dhe penale në Kosovë.*

hapat e nevojshëm për të mundësuar shkuarjen pa pengesa të stafit të EULEX-it dhe zëvendësimin e tyre nëpër gjykata, ndonëse ai ende ka nevojë të arrijë qëndrueshmëri të plotë institucionale.

KGJK-ja ka hartuar dy rregulloret e fundit të parapara me Pakon e Drejtësisë të vitit 2015. Këto rregullore (për gjyqtarët porotë dhe bashkëpunëtorët profesionalë) kanë qenë të gatshme për tu miratuar qysh atëherë, por KGJK-ja ka vendosur të pret miratimin e amendamenteve të *Ligjit për Gjykatat* dhe *Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës* për të shmangur amendamentimin e dyfishtë të rregulloreve. Ndonëse ky është vendim praktik, kërkesa ka qenë që këto rregullore të miratoheshin brenda gjashtë muajve në vitin 2015. KGJK-ja po ashtu e ka hartuar një rregullore me qëllim të përmirësimit të kornizës nënligjore për digjitalizimin e tërë


udhërrëfyes (për DhPGJS-në dhe Kolegjin e Apelit të AKP) përmbajnë një listë të veprimeve të parapara të ndërmerren nga institucionet e Kosovës për t'u përgatitur për përmbylljen e EULEX-it. Në këtë drejtim, KGJK-ja i ka ndërmarrë

sistemit të Kosovës me shënime penale nga koha e pasluftës e këtej. Ndërkaq, Sekretariati ende ka nevojë për avancimin e kapaciteteve të stafit mbështetës juridik për të qenë të aftë të hartojnë legjislacion sekondar në mënyrë të pavarur dhe me cilësi të mjaftueshme.

KGJK-ja i ka administruar proceset e punësimit si në vijim: 54 gjyqtarë të gjykatave themelore (19 nga të cilët janë caktuar në gjykatën më të ngarkuar: Gjykatën Themelore të Prishtinës), 40 gjyqtarë serb të Kosovës, si pjesë e marrëveshjes për drejtësi, pesë gjyqtarë për Gjykatën e Apelit, dy gjyqtarë për Gjykatën Supreme dhe një gjyqtar për Kolegjin e Apelit për AKP. Në qershor të vitit 2018, KGJK-ja ka qenë në mes të procesit të punësimit të 37 gjyqtarëve për nivelin e gjykatave themelore, ku shtatë pozita janë paraparë të plotësohen me staf nga komunitetet pakicë. Me përfundimin e këtij procesi të punësimit, numri i përgjithshëm i gjyqtarëve në Kosovë do të arrijë në 435 nga 452 pozitat e miratuara. Më tej, me tërheqjen e gjyqtarëve të EULEX nga DhPGJS-ja, KGJK-ja i ka punësuar shtatë gjyqtarë, emërimet e të cilëve janë vënë në pritje deri në ndryshimin e ligjit për DhPGJS-në. KGJK-ja në përgjithësi ka vepruar në pajtim me rregulloret në fuqi gjatë punësimit dhe avancimit të gjyqtarëve nëpër nivele më të larta të gjykatave.

Bazuar në të dhënat në dispozicion në qershor të vitit 2018, mbi dy të tretat e gjyqtarëve janë të gjinisë mashkullore, ndërsa gjyqtaret femra përbëjnë vetëm 32%. Sa i përket përfaqësimit etnik, shumica e gjyqtarëve (86%) janë shqiptarë të Kosovës, 11% janë serbë të Kosovës, ndërsa pjesa tjetër prej 3% janë nga komunitetet boshnjake, rome, ashkali, egjiptas dhe goran të Kosovës.

## Përfaqësimi etnik - gjyqtarët



Pas vendimeve nga Gjykata Kushtetuese në qershor 2017, KGJK-ja i ka ndryshuar procedurat e përzgjedhjes për kryetarët e gjykatave dhe gjyqtarët mbikëqyrës dhe i ka përsëritur proceset e votimit për kryetarin e Gjykatës Supreme dhe kryetarin e Gjykatës së Apelit. Procedurat e ndryshuara e kanë përmirësuar procesin e përzgjedhjes duke krijuar një fletëvotim për çdo proces të votimit në vend të përdorimit të votave të ndara për çdo kandidat. Gjatë periudhës së raportimit, KGJK-ja po ashtu i ka emëruar Kryetarët e Gjykatës Supreme, Gjykatës së Apelit, Gjykatës Themelore të Gjilanit, dhe, në pajtim me Marrëveshjen e Brukselit, janë emëruar dy gjyqtarë serb të Kosovës, përkatësisht, Kryetari i GjThM-së dhe Zëvendëskryetari i Gjykatës së Apelit. KGJK-ja po ashtu ka emëruar gjyqtarë mbikëqyrës për degët e GjThM-së në Leposaviq dhe Zubin Potok.

Këshilli ka dhënë komente për një sërë ligjesh të përgatitura nga Ministria e Drejtësisë, përkatësisht për ndryshimin e *Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës* dhe *Ligjit për Gjykatat*, si dhe *Projektligjit për Përgjegjësitë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve*. Në ndërkohë, Zyra për Përgjegjësitë Disiplinore ka vazhduar me performancë të dobët nën ushtruesin e ri të detyrës së drejtorit pjesërisht për shkak të trashëgimit të menaxhmentit të mëparshëm, meqë, për shembull, mes viteve

2011 dhe 2017 nuk është arkivuar asnjë lëndë si dhe për shkak të pritjes së miratimit të ligjit të lartcekur.

Komisioni për vlerësimin e performancës ka kryer me sukses vlerësimet e performancës të gjyqtarëve për vitin 2017 sipas përzgjedhjes së rastësishme. Gjithsej 66 gjyqtarë janë vlerësuar, dy me mandate fillestare dhe 54 me mandate të përhershme, ndërsa 10 kandidatë kanë qenë në proces të avancimit.

Arritje janë vërejtur tek menaxhimi i rrjedhës së rasteve. Me ndihmën nga donatorët, gjykatat kanë hartuar plane individuale të rrjedhës së rasteve për t'i shkurtuar periudhat e pritjes dhe për t'i eliminuar vonesat e paarsyeshme. Kjo ka treguar rezultate inkurajuese: shkalla e zgjidhjes është shtuar për 145% në fund të vitit 2017, ndërsa përqindja e rasteve të vjetra të papërfunduara ka rënë në 38.79% në gjysmën e parë të vitit 2018, krahasuar me 62.26% në vitin 2017. KGJK-ja po ashtu e ka përmirësuar transparencën e gjyqësorit duke e themeluar një grup punues në bashkërendim me donatorët. Grupi punues e ka si detyrë projektimin e një platforme të re gjyqësore online për t'u ofruar përdoruesve qasje të lehtë.

Sistemi Informativ për Menaxhimin e Lëndëve (SIML) është planifikuar të vihet në funksion deri në qershor të vitit 2018, por ka pasur një vonesë prej së paku 10 muajve, për shkak të disa arsyeve, përfshirë për shkak të lëvizjeve të stafit dhe mungesës së mjeteve financiare. Përveç shumë prej 6.6 milion euro tashmë të shpenzuara, Qeveria e Norvegjisë pritet të financojë edhe tri vite të tjera për ta përfunduar projektin. Pilotimi i projektit SIML ka filluar në Gjykatat Themelore të Ferizajt, Gjilanit, Prizrenit, Gjakovës dhe Pejës, vetëm për rastet penale, çka ka vënë në pah probleme të ndryshme të përkthimit në versionin e sistemit në gjuhën serbe.

**RRUGA PËRPARA:** Për të shënuar progresin e arritur tek institucionet e Kosovës për sundimin e ligjit, gjatë mandatit të tij të ri që fillon më 15 qershor 2018, EULEX-i më nuk do ta këshillojë KGJK-në. Zyra e BE-së do të vazhdojë ta mbështesë KGJK me një rol këshillues më të kufizuar në nivel strategjik.

## KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS

Gjatë periudhës që mbulohet me këtë raport, KPK-ja ka bërë hapa të konsiderueshëm drejt qëndrueshmërisë institucionale. Sistemi prokurorial ka vazhduar me ngritjen e numrit të

*KPK-ja është përgjegjës për të siguruar sistem prokurorial të pavarur, profesional dhe të paanshëm. KPK-ja vepron i pavarur nga ekzekutivi – masë e ndërmarrë për ta siguruar pavarësinë e gjyqësorit. Këshilli udhëhiqet prej Kryesuesit të KPK-së i cili punon për së afërmi me Kryeprokurorin e Shtetit, duke siguruar bashkërisht se sistemi prokurorial funksionon me efikasitet dhe në përputhje me ligjin.*

rasteve të zgjidhura dhe aktakuzave që kanë përfunduar me dënime në mbarë Kosovën. Sekretariati i KPK-së është bërë më i organizuar, më transparent dhe më i qëndrueshëm pas miratimit dhe zbatimit të rregulloreve përkatëse. KPK-ja e ka vazhduar praktikën e themeluar së fundmi për krijimin dhe përcjelljen e planeve të punës që pasqyrojnë mandatin dhe vizionin e Këshillit, të cilat përmbajnë aktivitete


specifike, indikatorë dhe afate kohore për zbatimin e tyre.

Pas një shtimi ndaj buxhetit të tij për vitin 2018, Këshilli i ka ndarë disa prej atyre mjeteve për 148 vendet e punës shtesë me qëllim të mbulimit të zbrazëtirave në sistem, në veçanti me staf mbështetës juridik. Mes periudhës korrik 2017 dhe qershor 2018, KPK ka punësuar 21 prokuror të shtetit për Prokuroritë Themelore (PTh), 13 prokurorë serb të Kosovës, në pajtim me Marrëveshjen e Brukselit, dhe 39 zyrtarë ligjorë, dhe ka filluar procesin e punësimit të edhe 55 bashkëpunëtorëve profesionalë për prokurorë. Si pjesë e strategjisë së saj të komunikimit, KPK-ja po ashtu i ka punësuar nëntë zyrtarë për informim dhe monitorim të mediave të caktuar për çdo PTh. EULEX ka vlerësuar se këto procese të punësimit janë zhvilluar në pajtim

me rregulloret. Më tej, pas miratimit të *Ligjit për Prokurorin e Shtetit*, i cili i ka zvogëluar kriteret për pozitat brenda Prokurorisë Speciale të Kosovës (PSRK-në), KPK-ja planifikon të punësojë prokurorë shtesë për këtë prokurori, e cila përgjatë viteve ka pasur mungesë të stafit – me qëllim të zvogëlimit të numrit të rasteve të papërfunduara të krimeve të luftës, krimin të organizuar dhe rasteve të tjera të krimeve të rënda.

Sipas të dhënave në dispozicion në qershor të vitit 2018, 61% e prokurorëve në Kosovë janë meshkuj ndërsa 39% janë femra. Sa i përket përfaqësimit etnik, shumica (91%) e prokurorëve janë shqiptarë të Kosovës, 8% janë serbë të Kosovës, ndërsa pjesa tjetër prej 1% janë turq dhe boshnjakë të Kosovës.

### Përfaqësimi etnik - prokurorët



Këshilli ka ndërmarrë hapa për ta përmirësuar kornizën e brendshme sa i përket punës me mediat. *Rregullorja për komunikim me publikun* kërkon që çdo PTh të caktojë një prokuror si person kontaktues për marrëdhëniet me mediat. Në dhjetor të vitit 2017, KPK-ja po ashtu e ka miratuar strategjinë e komunikimit që sistemi prokurorial ta përmirësojë cilësinë e komunikimit dhe ta rrisë llogaridhënien dhe transparencën e sistemit.



Me qëllim të zgjidhjes së sa më shumë rasteve përmes ndërmjetësimit, e jo përmes gjykatave, është themeluar një mekanizëm i referimit për ndërmjetësim. Si rezultat, gjatë vitit 2017 Prokurori i Shtetit i ka zgjidhur 7.92% të rasteve përmes ndërmjetësimit, krahasuar me 5.29% gjatë vitit 2016, ndërsa gjatë gjysmës së parë të vitit 2018, Prokurori i Shtetit ka zgjidhur deri në 11.18% të rasteve përmes ndërmjetësimit.

KPK-ja nuk ka mundur të përfundojë procesin e punësimit të anëtarit joprokurorial nga shoqëria civile në Këshill për shkak të mungesës së aplikimeve, ndërsa Kuvendi i Kosovës nuk i ka siguruar dy anëtarët e tjerë të paraparë joprokurorial nga Universiteti dhe Shoqata e Avokatëve. Me vendosjen e 10 prej 13 anëtarëve të paraparë, Këshilli ka vazhduar të funksionojë me kuorum të ngushtë (nëntë anëtarë).

Sistemi prokurorial nuk është prekur edhe aq nga vonesat në zbatimin e projektit të Sistemit Informativ për Menaxhimin e Lëndëve (SIML-së). Pilotimi i parë ka filluar në Ferizaj në qershor të vitit 2018, ndërkaq trajnime janë përgatitur për PTh e tjera.

KPK-ja ka vazhduar të përballet me sfida për hartimin dhe përkthimin e rregulloreve. Stafi

juridik ka nevojë t'i përmirësojë aftësitë e tyre për hartime juridike, ndërsa Këshilli ende ka nevojë për trajtimin e mospërputhshmërive në disa prej rregulloreve në versionet në serbisht. Ndërkaq, hartimi i rregulloreve disi është ngadalësuar, pjesërisht për shkak të pritjes për miratimin e ndryshimit të *Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës*, meqë ai mund ta prekë përmbytjen e rregulloreve.

Nga janari i vitit 2018 e këtej, KPK-ja, së bashku me Kryeprokurorin e Shtetit dhe PSRK-në, e ka filluar zbatimin e Udhërrëfyesit të BPSL-së për Krimet e Luftës. Ky Udhërrëfyes përmban një listë të veprimeve që parashihen të ndërmerren nga institucionet e Kosovës për ta siguruar funksionalitetin e plotë të institucioneve të përzgjedhura pas largimit të prokurorëve të EULEX-it. Udhërrëfyesi për krimet e luftës përqendrohet në hartimin dhe miratimin e *Strategjisë Nacionale për Krimet e Luftës* së bashku me stafin e EULEX-it para përfundimit të detyrave të tyre më 14 qershor 2018. Ndonëse drafti përfundimtar ka qenë i përgatitur në maj, miratimi përfundimtar ka ngecur, duke e lënë Kosovën të fundit në mesin e fqinjëve të saj nga ish-Jugosllavia sa i përket miratimit të strategjisë për krimet e luftës.

**RRUGA PËRPARA:** Për ta shënuar progresin e arritur në institucionet e Kosovës për sundimin e ligjit, gjatë mandatit të tij të ri që fillon më 15 qershor 2018, EULEX-i nuk do të këshillojë më KPK-në. Zyra e BE-së do të vazhdojë ta mbështesë KPK me një rol këshillues më të kufizuar në nivel strategjik.

## DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME

DhPGJS-ja ka vazhduar me gjykimin e rasteve për çështje të privatizimit nëpër trupa gjykes të përbëra me shumicë vendase. Gjatë periudhës që mbulohet me këtë raport, DhPGJS i ka zgjidhur 2070 raste. Meqë Dhoma e Posaçme ka vazhduar të pranojë kërkesa të reja (gjatë kësaj periudhe janë regjistruar 1976 raste të reja), numri i lëndëve të papërfunduara ka vazhduar të jetë i lartë, me 21,043 raste sipas të dhënave në qershor të vitit 2018. Pas përfundimit të mandatit ekzekutiv të EULEX-it në gjyqësor, shtatë gjyqtarë nga EULEX-i e kanë përfunduar punën e tyre në DhPGJS më 14 qershor 2018.

EULEX-i dhe gjyqtarët vendas kanë marrë pjesë në një grup punues për hartimin e ndryshimeve në *Ligjin për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështje që kanë të bëjnë me Agjencinë Kosovare të Privatizimit* nën

patronazhin e Ministrisë së Drejtësisë. Shtytja për këtë ndryshim ishte domosdoshmëria që në tekstin e ligjit të zëvendësohen të gjitha referimet e gjyqtarëve të EULEX-it. Ky rast është shfrytëzuar edhe për ndryshimin e mënyrës së funksionimit të DhPGJS-së për ta bërë atë më efikase dhe për ta integruar përfundimisht në Gjykatën Supreme dhe, kështu, për ta ulur potencialisht numrin e rasteve të papërfunduara. Ndryshimet e propozuara të bëra në administrimin e DhPGJS-së e kanë sistemuar DhPGJS-së në sistemin e përgjithshëm të gjykatave të Kosovës, përmes disa ndryshimeve, siç janë:

*DHPGJS merret me çështje që lidhen me privatizimin, përfshirë kërkesat rreth privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore të kryer nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (APK). Disa prej kërkesave përfshijnë asete me miliona euro.*

- Krijimi i praktikës së “gjyqtarëve të vetëm” për shkallën e parë (ku një gjyqtar i vetëm mund të vendosë për rastin në vend të kolegjit të përbërë nga tre gjyqtarë, me përjashtim të rasteve me pronësi të ndërlikuar dhe rasteve të privatizimit);
- Përbërjet e reja të kolegjeve të apelit, ku në vend të një kolegji të përbërë nga pesë gjyqtarë, do të kishte së paku dy kolegje të përbëra nga tre gjyqtarë. Një mekanizëm i posaçëm krijohet për ta unifikuar gjykimin e këtyre dy kolegjeve;
- Anulimi i Presidiumit të DhPGJS-së dhe zëvendësimi i tij nga një organ ekzistues, Kolegjiumi i Gjyqtarëve të Gjykatës Supreme, i cili do të përfshinte gjyqtarët e Dhomës së Posaçme;
- Kryetari i Gjykatës Supreme bëhet Kryetar i DhPGJS-së (me dy role) për ta integruar DhPGJS-në në Gjykatën Supreme;
- Caktimi i gjyqtarit mbikëqyrës: gjyqtari mbikëqyrës – i emëruar nga KGJK nga ekipi i gjyqtarëve kryesues të kolegjeve të apelit – i paraparë të jetë përgjegjës për menaxhimin ditor të DhPGJS do të raportonte tek Kryetari i Gjykatës Supreme, i mbështetur nga administratori i gjykatës dhe regjistruesi kryesor.


Për shkak të ndërlikueshmërive të proceseve legjislative dhe politike, propozimi i Kryeministrit – sipas kërkesës së Ministrit të Drejtësisë – për të mbajtur seancë të jashtëzakonshme për shqyrtimin e projektligjit nuk është lejuar nga Kuvendi i Kosovës.

Si rezultat, projektligji nuk është miratuar nga Kuvendi para përfundimit të mandatit të EULEX-it në DhPGJS, andaj DhPGJS i ka ndalur përkohësisht gjykimet e rasteve. Diçka që vlen të theksohet si pozitive, është se në maj të vitit 2018, EULEX-i e ka organizuar një trajnim

njëditor, ku gjyqtarët e EULEX-it kanë prezantuar metoda të ndryshme para gjyqtarëve vendas të DhPGjS-së, të cilat, nëse aplikohen, do të ndihmonin në zvogëlimin e numrit të rasteve të papërfunduara të kërkesave masive në DhPGjS. Gjatë periudhës

që mbulohet me këtë raport, për Regjistrin e DhPGjS-së nuk është bërë asnjë përmirësim, dhe ky Regjistër vazhdon të ketë nevojë të zbatojë sistem të duhur dhe të qëndrueshëm të menaxhimit të lëndëve.

**RRUGA PËRPARA:** Duke e vërejtur gatishmërinë e përgjithshme të gjykatave të Kosovës për të funksionuar pa angazhim ndërkombëtar të integruar, EULEX-i i ka tërhequr gjyqtarët e vet nga DhPGjS-ja në fund të mandatit të tij paraprak më 14 qershor 2018. Gjatë mandatit të ri, EULEX do të monitorojë punën e DhPGjS-së, duke u përqendruar si tek drejtësia, ashtu edhe tek administrimi i gjykatës si dhe tek zbatimi i Ligjit të amendamentuar për DhPGjS-së pasi të miratohet.



## KOLEGJI I APELIT TË AGJENCISË KOSOVARE TË PRONËS

Kolegji i Apelit të AKP vazhdoi me shqyrtimin e ankesave, duke mbyllur kështu gjithsej 111 raste për periudhën e mbuluar nga ky raport. Kolegji ka shqyrtuar raste me shumicë vendase, me dy gjyqtarë vendas dhe një gjyqtar nga EULEX-i, dhe me kryetar të trupit gjykues

*Kolegji i Apelit të AKP është pjesë e Gjykatës Supreme dhe merret me ankesat kundër vendimeve të dhëna nga AKP rreth kontesteve pronësore private. Kolegji i Apelit për AKP merret vetëm me pronat private dhe të paluajtshme të humbura gjatë dhe për shkak të konfliktit të vitit 1999. Shumica e ankesave janë për raste të kontestuara mes grupeve etnike të ndryshme në Kosovë (kryesisht shqiptarë të Kosovës/serbë të Kosovës).*

vendas. Për shkak të ndryshimit të mandatit, gjyqtarët nga EULEX-i kanë përfunduar punën e tyre më 14 qershor 2018, dhe bazën e të dhënave të Kolegjit e kanë dorëzuar tek regjistruesi vendas i sapoemëruar. Në kohën kur EULEX-i i ka tërhequr gjyqtarët e vet nga Kolegji në qershor, ai ende kishte një numër prej 160 rasteve të papërfunduara. Më tej, Gjykata Supreme i ka marrë përsipër

shërbimet e përkthimit për Kolegjin e Apelit të AKP. KGJK ka miratuar një pozitë për një përkthyes për gjuhët shqip-serbisht.

Kryesuesi vendas i Kolegjit të Apelit të AKP është pensionuar në korrik 2017. Për shkak të vonesave në procesin e punësimit, pozita e tij ishte plotësuar përkohësisht me tre gjyqtarë nga Gjykata Supreme që ndërroreshin çdo muaj deri në emërimin e përhershëm të një gjyqtari në janar 2018. Ndonëse Kolegji teknikisht ka vazhduar punën, ajo ishte një zgjidhje më pak se ideale meqë gjyqtarët që ishin emëruar përkohësisht nuk kanë mundur të bëjnë asnjë hartim të nevojshëm për gjykime, kështu, janë bazuar në draftet e përgatitura nga gjyqtarët e Kolegjit të Apelit të AKP.

Duke pas parasysh se mandati ekzekutiv gjyqësor i EULEX-it ka përfunduar më 14 qershor 2018, përfundimi i punës së gjyqtarëve të EULEX-it në Kolegjin e Apelit të AKP duhet të adresohet përmes ndryshimeve në *Ligjin për Agjencinë Kosovare për Krahësimin dhe Verifikimin e Pronës* (AKKVP-në). Ligji ka qenë në proces të ndryshimit nga Zyra e Kryeministrit, ndërsa Kolegji nuk ka mundur t'i gjykojë rastet deri në zgjidhjen e kësaj çështje. EULEX-i e ka rekomanduar përdorimin e ndryshimit të Ligjit për AKKVP për shqyrtimin e përbërjes së kolegjit të gjyqtarëve në Kolegjin e Apelit të AKP, në veçanti për të siguruar se gjyqtari i tretë përfaqëson komunitet pakicë. Kjo do të ishte në pajtim me *Ligjin* e ndryshuar për *Gjykatat* në të cilin kërkohet që përbërja e Gjykatës Supreme dhe Kolegjeve të saj ta pasqyrojnë përbërjen etnike të popullatës së Kosovës.

Në përputhshmëri me ligjin, AKKVP-ja e ka bërë dërgimin e lëndëve me ankesë drejtpërdrejt tek Kolegji i Apelit të AKP, ku ato janë regjistruar në bazën e të dhënave të administruar nga EULEX-i. Me largimin e gjyqtarëve të tij, EULEX-i e ka dorëzuar këtë bazë të të dhënave tek regjistruesi i Kolegjit të Apelit të AKP. Për të siguruar administrim të duhur të rasteve, EULEX-i i ka këshilluar që të fillojnë me regjistrimin e rasteve edhe në regjistrin e Gjykatës Supreme.

Një risi e rëndësishme është arritur për krijimin e një metode për dërgimin e vendimeve të shkallës së parë të Komisionit të Kërkesave Pronësore të Kosovës (tani joekzistent) dhe të aktgjykimeve të shkallës së dytë të Kolegjit të Apelit të AKP-së tek personat e zhvendosur të cilët janë jashtë Kosovës. Që nga viti 2015, nuk ka ekzistuar asnjë mekanizëm që do ta mundësonte këtë. Nga bashkëpunimi i ngushtë mes Kolegjit të Apelit të AKP-së, EULEX-it,

PSBE-së, Ministrisë së Drejtësisë në Kosovë dhe AKKVP-së, 15 aktgjykimet e para janë dërguar në Ministrinë e Drejtësisë në Serbi përmes mekanizmit të Ndihmës Juridike Reciproke në prill të vitit 2018. Ministria e Drejtësisë në Serbi që atëherë e ka filluar procesimin e tyre dhe ka filluar të bëjë përpjekje t'i kontaktojë palët dhe t'i dërgojë aktgjykimet. Qëllimi i këtij procesi

është që të dërgohen të gjitha vendimet që janë në pritje (ndaj të cilave mund të paraqitet ankesë) dhe të gjitha aktgjykimet që janë në pritje (që në disa raste kërkojnë zbatim). Pas dërgimit të të gjitha vendimeve dhe procesimit të apeleve që dalin, Kolegji do ta ketë përmbushur rolin e vet.

**RRUGA PËRPARA:** Duke e vërejtur gatishmërinë e gjyqësorit të Kosovës për të funksionuar pa angazhim ndërkombëtar të integruar, EULEX-i i ka tërhequr gjyqtarët e vet nga Kolegji i Apelit të APK-së në fund të mandatit të tij paraprak më 14 qershor 2018. Si rrjedhojë, Kolegji ka filluar të funksionojë si institucion i përbërë krejtësisht nga gjyqtarë vendas. Gjatë mandatit të ri, EULEX do ta monitorojë Kolegjin e Apelit të APK-së duke u përqendruar si tek drejtësia, ashtu edhe tek administrimi i gjykatës si dhe tek dërgimi i vendimeve dhe aktgjytimeve.

## SHËRBIMI KORREKTUES I KOSOVËS

Gjatë periudhës raportuese, Shërbimi Korrektues i Kosovës (ShKK) ka treguar zhvillim modest drejt standardeve të BE-së. Trajtimi preferencial i të burgosurve të profilit të lartë paksa është zvogëluar duke pasur parasysh se disa prej tyre janë liruar, ndërsa të tjerët kanë mbërritur në fazën kur u takojnë pushime të rregullta. Megjithatë, të burgosurit e tjerë të profilit të lartë kanë vazhduar të kenë trajtim të favorizuar, si përmes numrit të lartë të ditëve të pushimeve të jashtëzakonshme, ashtu edhe përmes qasjes më të lehtë në shërbimet mjekësore të jashtme krahasuar me të burgosur të tjerë. Një shembull i theksuar i kësaj ka ndodhur në shkurt të vitit 2018, kur një të burgosuri të profilit të lartë i është dhënë pushim i paplanifikuar për të qenë i pranishëm në dasmën e vëllait të vet. Një i burgosur tjetër i profilit të lartë është hospitalizuar që nga marsi i vitit 2018 – që ka ndodhur menjëherë pas kthimit të tij nga ndërprerja e dënimit dhe me masa të lehta të sigurisë. Ndërkaq, në shtator të vitit 2017, ShKK-ja nuk i ka dhënë informata të sakta një paneli për lirim me kusht, çka ka rezultuar që paneli ka liruar dy të burgosur meshkuj shqiptarë të Kosovës të profilit gjysmë të lartë me historik të shkeljeve disiplinore dhe një rast gjyqësor në proces për mosrespektim të rregullave të burgut.

Procesi i punësimit të stafit të ShKK-së ka vazhduar të jetë sfidues. Duke u nisur nga një aspekt pozitiv, pas anulimit të një procesi diskutabil të punësimit për shkak të një vargu të parregullsive që i kishte ngritur EULEX-i, punësimi i drejtorit të përgjithshëm të ShKK-së më në fund është përfunduar dhe drejtori i ri është emëruar në pozitë në prill të vitit 2018. Ndërkaq, disa përpjekje për të punësuar staf në ShKK janë anuluar gjatë vitit të kaluar. Punësimi i 70 zyrtarëve korrektues të ri, i drejtorit dhe zëvendësdrejtorit për Qendrën e Paraburgimit në Prizren dhe i drejtorit për Qendrën e

Paraburgimit në Gjilan është anuluar në korrik 2017, pas mbajtjes së provimeve me shkrim, testeve fizike dhe intervistave në shumë prej rasteve, ndërkaq nuk është dhënë asnjë arsytim për anulimin. Një proces tjetër është anuluar në prill të vitit 2018, pasi që Avokati i Popullit në Kosovë publikisht e ka kritikuar caktimin e kufizimit të moshës për pozitën, duke e quajtur atë si diskriminim për shkak të moshës. Ministria e Drejtësisë e ka anuluar atë proces të punësimit për ta siguruar respektimin e të drejtave të njeriut në pajtueshmëri me Kushtetutën e Kosovës dhe konventat ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Pozitat për 70 zyrtarët korrektues të ri janë planifikuar të rishpallen në gjysmën e dytë të vitit 2018. Vështirësitë legislative të mëparshme për kryerjen e proceseve të punësimit, në veçanti për pozitën e larta, kanë shpënë në një situatë ku pozitën e menaxhmentit të lartë të ShKK-së në masë të madhe janë plotësuar me ushtrues të detyrave të emëruar përkohësisht në ato pozita. Kjo, si pasojë, ka rezultuar me menaxhim të dobët dhe mundësi për ndërhyrje nga jashtë. Megjithatë, që kur e ka marrë pozitën, Drejtori i Përgjithshëm i ri i ShKK-së i ka plotësuar në mënyrë të përhershme të gjitha pozitën e menaxhmentit të mesëm që për periudha të gjata janë ushtruar nga ushtrues detyre, ndërsa ai ka bërë shpallje për vende të lira të punës për pozitën e tjera të paplotësuara të menaxhmentit të mesëm. Planet për punësimin dhe emërimin e menaxherëve të lartë janë në pritje të miratimit të projektligjeve që janë mbështetur nga EULEX.

Një progres i caktuar është arritur tek riorganizimi i objekteve të ShKK-së. Një qendër edukativo-korrektuese për të miturit është inauguruar zyrtarisht në Lipjan në shtator të vitit 2017 – një hap para drejt sigurimit të një objekti për ShKK-së për të ndihmuar në uljen e përsëritjes së veprave në mesin e shkelësve të ri




në moshë. Megjithatë, që kur është hapur qendra, ajo është ballafaquar me probleme të ofrimi i aktiviteteve të parapara të rehabilitimit dhe programeve të edukimit për të burgosurit e mitur. Ndonëse ka pasur progres të caktuar tek parandalimi i kontrabandimit të narkotikëve në objekt, disa të burgosur janë gjetur të kenë pasur në posedim substanca të paligjshme. ShKK-ja e ka përgatitur një plan për t'i shtuar masat e sigurisë për të luftuar këtë fenomen, i cili është i zakonshëm në burgje nëpër tërë botën.

Pas vonesave të njëpasnjëshme, jashtë kontrollit të ShKK-së, në janar të vitit 2018 Ministria e Administratës Publike ia ka dorëzuar Qendrën e re të Paraburgimit në Prishtinë Ministrisë së Drejtësisë dhe ShKK-së. Objekti – që ka mundësi t'i akomodojë 300 të burgosur – ende nuk është i gatshëm për tu hapur për shkak të mungesës së pajisjeve bazë si dhe për shkak të disa punimeve ndërtimore në pritje, për të bërë ndërtesën funksionale dhe të sigurt. Planet për rivendosjen e burimeve për

ta hapur objektin në shtator të vitit 2018 janë të gatshme.

Në fund, nuk është bërë asnjë përpjekje për ta filluar përdorimin e dhomave të sigurta në ish-repartin psikiatrik të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, pavarësisht rinovimit të tyre në fund të vitit 2016. Ndonëse tani ekzistojnë kushtet për të trajtuar të burgosur në një objekt të pajisur posaçërisht për këtë qëllim, ShKK-ja ka vazhduar t'i sigurojë repartet e rregullta në po atë spital për trajtimin e të burgosurve, çka kërkon kështu prani të madhe të ShKK-së për ta parandaluar ikjen e tyre. Ky opsion i vë pacientët e tjerë dhe qytetarët në rrezik, meqë e shton mundësitë e ikjes së të burgosurve. Kjo është dëshmuar me ikjen e një të burgosuri të dënuar për vrasje të rëndë, i cili ka qenë në trajtim mjekësor në një zonë të pasiguar në shtator të vitit 2017. Ndërkaq, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Shëndetësisë kanë përgatitur një memorandum të bashkëpunimit për përdorimin e objekteve në të ardhmen.

**RRUGA PËRPARA:** Gjatë mandatit të tij të ri, EULEX-i do të vazhdojë me monitorimin, mentorimin dhe këshillimin e menaxhmentit të lartë të ShKK-së. Më konkretisht, EULEX-i do të vazhdojë të punojë në partneritet me drejtorin e përgjithshëm të ShKK dhe stafin e tij të lartë për të siguruar që të krijohen kushte që më të mos ketë nevojë për mbështetjen e EULEX-it, duke i adresuar mangësitë që kanë mbetur dhe duke ndihmuar në parandalimin e ndërhyrjeve nga jashtë.



## INSTITUTI I MJEKËSISË LIGJORE

IML-ja e ka vazhduar punën për identifikimin dhe gjetjen e lokacioneve të personave të zhdukur nga konflikti i vitit 1999, që është pjesë

*Zhvarrimet janë bërë në: Gjakovë, Klinë, Prizren, Fushë Kosovë, Mitrovicë të veriut dhe Kukës, Shqipëri*

*Stafi i EULEX në IML:*

- *Ka ndihmuar për kthimin e 506 mbetjeve mortore të personave të zhdukur në Kosovë tek familjet e tyre;*
- *Ka kryer 595 operacione në terren dhe 430 identifikime – 300 prej të cilëve ishin të personave të zhdukur;*
- *Ka ndihmuar për analizat e 2261 mostrave të ADN.*

*Numri i personave të zhdukur është 1651, prej të cilëve 265 femra dhe 1386 meshkuj.*

thelbësore e procesit të pajtimit pas konfliktit. Numri i personave të zhdukur si pasojë e konfliktit ka rënë në 1649. Gjatë periudhës që mbulohet me këtë raport, Instituti i ka kryer tetë zhvarrime në Kosovë dhe një në Shqipëri. Instituti me sukses i ka identifikuar 10 persona dhe i ka dorëzuar mbetjet mortore të nëntë personave të zhdukur tek familjarët e tyre. Puna e rëndësishme për identifikimin e personave të zhdukur kërkon mbështetje të

vazhdueshme politike dhe institucionale për t'i përfunduar rastet që kanë mbetur.

Punë më e madhe nevojitet për përmirësimin e mënyrës së punës të IML-së si institucion. Ndonëse Kryeministri dhe Ministri i Drejtësisë publikisht kanë shprehur zotimin për fuqizimin e IML-së, kjo mbështetje politike ende nuk ka rezultuar me ndonjë progres institucional. Pas miratimit të *Ligjit për Mjekësinë Ligjore* në mars të vitit 2016, legjislacioni dytësor i paraparë për

themelimin e një kornize organizative për IML-në është ende në pritje, duke e lënë këtë institucion të dobët dhe politikisht të cenueshëm. IML-ja ka qenë objekt i një mase të caktuar të presionit politik, pasi që është udhëzuar që ta informojë Zyrën e Kryeministrit për rastet e reja para se të ndërmarrë ndonjë hap për hetimin e tyre. Zhvillime të caktuara janë bërë sa i përket punësimit të drejtorit të IML. Ndonëse pozita është shpallur tri herë mes periudhës korrik 2017 dhe qershor 2018 për shkak të mungesës së kandidatëve të kualifikuar, procesi më në fund ka vazhduar me fazën e intervistave në qershor të vitit 2018. Më tej, IML-ja e ka pasur një ngritje të buxhetit, meqë Ministria e Drejtësisë i ka ndarë edhe 300,000€ për IML-në (€100,000 çdo vit për një periudhë trevjeçare) si pjesë e kriterëve për bashkëfinancim për një projekt të IPA-së të financuar nga BE-ja.

Në nivel operacional, institucioni ka pasur sfida për arritjen e një niveli të mjaftueshëm të produktivitetit, meqë stafi ka nevojë për asistencë dhe trajnime të mëtejme për të arritur kapacitete të plota operationale. EULEX-i ka vazhduar me trajnimin në vend të punës të dy antropologëve forenzikë të ardhshëm, të cilët po ashtu e kanë kryer një kurs online për antropologjinë forenzike në shkurt të vitit 2018 – që ka rezultuar me disa përmirësime tek kapacitetet e stafit. Numri i papërfunduar i autopsive ka vazhduar të bie me ritëm të ngadaltë.

**RRUGA PËRPARA:** Gjatë mandatit të ri, ekspertët forenzikë të EULEX-it do të vazhdojnë të jenë në dispozicion për ta mbështetur institutin sipas kërkesës së autoriteteve të vendit. Përveç kësaj, një projekt i IPA-s i nisur në shkurt 2018 ka për qëllim fuqizimin e IML-së dhe punës së tij për personat e pagjetur përmes ngritjes së kapaciteteve teknike dhe administrative të Institutit përgjatë një periudhe prej 36 muajve.



# ZBATIMI I DIALOGUT



## REGJISTRI CIVIL

Progresi ka ngecur në zgjerimin e sistemit plotësisht të besueshëm dhe të qëndrueshëm të regjistrimit civil në pjesën veriore të Kosovës. Zhvillimi më domethënës ka ndodhur në korrik të vitit 2017, kur Ministria e Punëve të Brendshme e ka miratuar një udhëzim administrativ për ndryshimin e parakushteve për marrjen e nënshtetësisë së Kosovës. Miratimi i *Udhëzimit administrativ për kriteret*

*që përmbajnë prova rreth nënshtetësisë së IRJ-së dhe vendbanimit të përhershëm në territorin e Kosovës më 1 janar 1998* ka qenë i nevojshëm për dhënien e udhëzimeve të hollësishme rreth llojeve të dokumenteve të nevojshme për të aplikuar për

nënshtetësinë e Kosovës dhe kështu për t'ua mundësuar banorëve nga pjesa veriore e Kosovës që të aplikojnë për dokumente identifikimi të Kosovës. Megjithatë, në udhëzim trajtohen vetëm disa prej çështjeve me të cilat banorët ballafaqohen me rastin e aplikimit për dokumente të Kosovës, në veçanti për ata që në të kaluarën janë bazuar në masë të madhe në dokumentet e lëshuara nga Serbia. Zbatimi i udhëzimit administrativ po ashtu është bërë në mënyrë të paunifikuar nga stafi i zyrës së gjendjes civile nën administrimin e komunave. Si përgjigje ndaj kësaj, EULEX-i e ka organizuar një punëtori për stafin e zyrës komunale për gjendje civile, Agjencinë e Regjistrimit Civil dhe

gjendje civile, Agjencinë e Regjistrimit Civil dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme në prill të vitit 2018, për ta mundësuar një forum për të diskutuar dhe dhënë udhëzime për zbatimin e këtij udhëzimi. Si rezultat, EULEX-i e ka paraqitur rekomandimin për harmonizimin e zbatimit të udhëzimit në Agjencinë e Regjistrimit Civil. Nevojiten hapa të mëtejme për të siguruar zbatimin e njësuar të udhëzimit

administrativ nga tërë stafi si dhe për t'i zgjidhur çështjet e mbetura me të cilat ballafaqohen banorët në pjesën veriore të Kosovës me rastin e aplikimit për dokumente të Kosovës.

Pas vonesave të shumta, procesi i integritetit të 39 stafit administrativ nga

ish-MUP-i (Ministria e Brendshme e Serbisë) në katër zyrat e gjendjes civile të pjesës veriore është kompletuar në nivelin qendror. Megjithatë, një takim i caktuar për fillimin e procesit zyrtar të punësimit në prill të vitit 2018 është anuluar, duke e shtyrë më tej integrimin e stafit. Që atëherë, përfaqësuesit e komunave në pjesën veriore të Kosovës kanë kërkuar një sistematizim të stafit në zyrat e gjendjes civile nga ana e Ministrisë së Administratës Publike para integritetit të stafit. Pas integritetit, 39 punonjësit nga ish-MUP-ja parashihen ta fillojnë punën në Zyrat e Gjendjes Civile ku ata do të regjistrojnë popullatën në pjesën veriore të Kosovës në kornizën e Kosovës.

**RRUGA PËRPARA:** Me përmbylljen e mandatit paraprak më 14 qershor 2018, EULEX e ka tërhequr rolin këshillues rreth çështjeve që ndërlidhen me regjistrin civil. Në mandatin e ri, EULEX ka ngushtuar mbështetjen dhënë Agjencisë së Regjistrimit Civil në zbatimin teknik të marrëveshjes për liri të lëvizjes të dalë nga dialogu. Paralelisht, Zyra e BE-së do të vazhdojë të mbështesë zhvillimin e çështjeve të regjistrimit të gjendjes civile në Kosovë me një rol këshillues më të kufizuar. Më tej, që nga shtatori 2017, Zyra e BE-së e ka mbështetur Agjencinë e Regjistrimit Civil përmes një projekti 30-mujor të binjakëzimit me qëllim të përmirësimit të standardeve dhe sigurisë së dokumenteve në sistemin e regjistrimit civil të Kosovës.

## LIRIA E LËVIZJES

Pak progres është shënuar tek arritja e lëvizjes së lirë të njerëzve dhe veturave mes Kosovës dhe Serbisë, në veçanti meqë reregjistrimi i veturave në pjesën veriore të Kosovës ende nuk ka filluar. Në korrik të vitit 2017, Ministria e Punëve të Brendshme e ka pranuar pakon e parë prej 300,000 fletave ngjitëse të parapara për t'i mbuluar shkurtetat dhe stemat e tabelave të veturave me regjistrim të Serbisë me rastin e udhëtimit nëpër Kosovë. Megjithatë, data e zbatimit të përdorimit reciprok të fletave ngjitëse nga autoritetet e Kosovës dhe ato të Serbisë ende nuk është miratuar, andaj, fletat ngjitëse ende nuk janë përdorur. Si pasojë, pronarët e veturave me tabela RKS ende duhet të paguajnë për përdorimin e tabelave provuese të Serbisë gjatë udhëtimeve nëpër Serbi.

Pas avokimeve të vazhdueshme nga këshilltarë të EULEX-it, hapa të rëndësishëm janë bërë në shtyrjen përpara të marrëveshjes për lirinë e lëvizjes të vitit 2011. Përkatësisht, në dhjetor të vitit 2017, ministri i punëve të brendshme e ka nxjerrë një vendim për ta mundësuar zëvendësimin e patentë shoferëve të Serbisë të administruar gjatë periudhës nga 10 qershor i vitit 1999 deri më 14 shtator të vitit 2016, sipas marrëveshjeve të arritura nga Prishtina dhe Beogradi në Bruksel. Rrjedhimisht, mes periudhës 15 dhjetor 2017 dhe 31 maj, janë procesuar 3668 aplikacione, prej të cilëve 1949 kanë qenë nga pjesa veriore e Kosovës – numër ky i konsiderueshëm për këtë periudhë kohore. Kjo është përcjellë me progres të mëtejshëm në mars të vitit 2018, kur ministri e ka nënshkruar një udhëzim administrativ për të mundësuar reregjistrimin e veturave me tabela të Serbisë të regjistruara midis viteve 1999 dhe 2016 me tabela të Kosovës. Ministri po ashtu e ka nënshkruar një vendim për të përjashtuar tarifa

të caktuara për reregjistrimin e veturave të njëjta dhe për ta pranuar çdo certifikatë të kontrollit teknik të paraqitur nga aplikuesi.

Ndonëse marrëveshja për lirinë e lëvizjes është zbatuar në plotësi në pjesën jugore të Kosovës, shumica e veturave në pjesën veriore të Kosovës mbajnë tabela të lëshuara nga Serbia apo nuk kanë tabela fare. Një numër i elementeve të nevojshme për ofrimin e shërbimeve për regjistrimin e veturave në pjesën veriore të Kosovës ende mungojnë.

Shumë serbë të Kosovës, në veçanti nga pjesa veriore e Kosovës, kanë raportuar vështirësi për marrjen e nënshtetësisë së Kosovës për shkak të praktikës shumë të përhapur të bazuarit vetëm në dokumente të lëshuara nga Serbia në komunat veriore gjatë viteve të kaluara. Nënshtetësia kosovare nevojitet për të aplikuar për patentëshoferë dhe tabela të Kosovës. Më

*Marrëveshja e vitit 2011 për lirinë e lëvizjes ka dalë nga dialogu mes Prishtinës dhe Beogradit, i lehtësuar nga BE-ja. Marrëveshja parasheh lëvizje të lirë të njerëzve dhe veturave dhe bazohet në parimin e reciprocitetit të plotë mes Kosovës dhe Serbisë. Në praktikë, ajo i mundëson popullatës që jeton në Kosovë të lëvizë në Serbi me dokumente të Kosovës dhe anasjelltas.*

tej, objektet dhe infrastruktura e nevojshme, shërbimet e inspektimit teknik, degët e sigurimit dhe autoshkollat që veprojnë brenda kornizës së Kosovës ose nuk janë themeluar në katër komunat e veriut, ose nuk janë plotësisht funksionale. Ndonëse themelimi i disa prej këtyre shërbimeve varet nga negociatat e mëtejme në Bruksel, zotim më i fuqishëm ministror nevojitet nga Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Administratës Lokale dhe Ministria e Financave për ta shtyrë më tutje zbatimin e aranzhimeve të dakorduara mes Prishtinës dhe Beogradit.

**RRUGA PËRPARA:** Gjatë mandatit të ri, EULEX-i do të vazhdojë t'i monitorojë, mentorojë dhe këshillojë palët për zbatimin teknik të marrëveshjes për lirinë e lëvizjes të dalë nga dialogu, deri në atë periudhë kur përgjegjësitë të transferohen tek ndonjë mekanizëm tjetër i BE-së, mundësisht tek PSBE-ja.

## MARRËVESHJA PËR MIK

Ndërtimi i Pikëkalimeve të Përbashkëta (PP) mes Kosovës dhe Serbisë – siç parashihet me dialogun e lehtësuar nga BE-ja – ka vazhduar të shënojë progres me ritëm të ngadaltë. Ndërtimi i dy prej tre PP-ve nën përkujdesjen e Prishtinës ka avancuar pavarësisht disa vështirësive teknike gjatë procesit të ndërtimit, ndërkaq progresi në PP-në e tretë është bllokuar për shkak të problemeve politike. Gjatë këtij procesi, EULEX-i është ftuar të ndërmjetësojë mes dy palëve dhe ka arritur të zgjidhë shumë çështje, çka e ka mundësuar vazhdimin e punimeve në shumicën e rasteve. Në anën e Kosovës, PP të reja në Mutivodë dhe Merdarë priten të hapen në vitin 2018, ndërsa ndërtimi i PP-së në Bërnjak nuk ka shënuar progres përgjatë periudhës së raportimit për shkak të mosveprimit të autoriteteve të vendit në pjesën veriore të Kosovës për ta gjetur një zgjidhje për zhvendosjen e kablove të energjisë elektrike që kalojnë nëpër vendpunim. Ndërkaq, meqë Beogradi nuk ka ndërmarrë asnjë hap për ta filluar ndërtimin e tri PP-ve për të cilat është pajtuar të përkujdeset, Delegacioni i BE-së në Serbi e ka anuluar kontratën për këtë qëllim.

Një grup për zbatimin e MIK-së, i përbërë prej përfaqësuesve të Prishtinës, Beogradit dhe BE-së (EULEX-it) është themeluar për ta siguruar zbatimin e protokollit teknik për MIK-së dhe për të propozuar masa për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe/apo konflikteve. I paraparë të takohet çdo tre muaj, pas një periudhe 16-mujore, ky grup është takuar prapë

në Bruksel në mars të vitit 2018. Palët kanë prezantuar informata dhe kanë ngritur çështjet e mbetura pezull në lidhje me ndërtimin në proces të PP-ve dhe kanë diskutuar rreth problemeve të ndërlidhura me lëvizjen e mallrave nëpër pikëkalime.

Sa i përket zbatimit të protokollit teknik për MIK-në, EULEX-i po ashtu ka vazhduar të jetë i pranishëm nëpër takimet rreth MIK-së mes zyrtarëve nga Kosova dhe atyre nga Serbia në nivele rajonale dhe lokale, ndërkaq një takim i nivelit qendror i caktuar të mbahet në shtator 2017 është shtyrë pa ndonjë afat. Takimet e nivelit rajonal dhe lokal janë mbajtur me rregull dhe në frymë të mirë, ku është mundësuar që përfaqësuesit përkatës nga të

dyja palët të takohen dhe t'i zgjidhin çështjet në lidhje me kalimin e njerëzve dhe mallrave nëpër PP. Si rezultat, PP-të mes Kosovës dhe Serbisë kanë shënuar kohën e pritjes më të shkurtë që është regjistruar ndonjëherë gjatë verës së vitit 2017, pavarësisht ngritjeve të numrit të udhëtarëve dhe veturave krahasuar me vitet e mëparshme. Fakti se koha e pritjeve është reduktuar në masë drastike dhe se ankesat nga udhëtarët kanë qenë të kufizuara mund plotësisht t'u atribuohet niveleve në përmirësim të bashkëpunimit mes dy palëve të autoriteteve që punojnë nëpër PP. Megjithatë, si reagim ndaj arrestimit të drejtorit të Zyrës së Serbisë për Kosovën dhe Metohinë në mars të vitit 2018, Serbia i ka anuluar takimet për MIK-në në të gjitha nivelet.

*MIK në kontekstin e dialogut Prishtinë-Beograd i referohet protokollit teknik për zbatimin e konkluzioneve të miratuara për MIK nga viti 2011 dhe planit të veprimit nga viti 2012 – i dedikohet themelimit të gjashtë pikëkalimeve të përbashkëta mes Kosovës dhe Serbisë.*

**RRUGA PËRPARA:** Gjatë mandatit të ri, EULEX-i do të vazhdojë t'i monitorojë, mentorojë dhe këshillojë palët për zbatimin teknik të protokollit teknik për MIK-në të ndërlidhur me dialogun, deri në atë periudhë kur përgjegjësitë të transferohen tek ndonjë mekanizëm tjetër i BE-së, mundësisht tek PSBE-ja.



## INTEGRIMI I DREJTËSISË

Më 24 tetor të vitit 2017, 40 gjyqtarë dhe 13 prokurorë serbë të Kosovës zyrtarisht i janë

*Integrimi i sistemit të drejtësisë në pjesën veriore të Kosovës është një prej shumë proceseve që ndërlidhen me dialogun në vazhdim mes Kosovës dhe Serbisë. Banorët në katër komunat e pjesës veriore kanë pasur qasje të kufizuar në drejtësi që nga mbyllja e gjykatës së administruar nga UNMIK-u në vitin 2008, çka ka ndikuar shumë në jetën e përditshme të qytetarëve të rëndomtë në pjesën veriore të Kosovës. Në vitet 2013 dhe 2015 janë marrë një sërë vendimesh politike për ta krijuar një kornizë gjyqësore të unifikuar nëpër tërë Kosovën, duke kulminuar me integrimin zyrtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve serbë të Kosovës në tetor të vitit 2017.*

bashkuar sistemit gjyqësor të Kosovës pas dekretimit nga Presidenti i Kosovës, duke shënuar kështu një të arritur të madhe për sundimin e ligjit. Në pajtim me Marrëveshjen e Brukselit, në tetor të vitit 2017 në GjThM një serb i Kosovës është emëruar kryetar dhe në dhjetor të vitit 2017 në Gjykatën e Apelit në Prishtinë një serb i Kosovës është emëruar zëvendëskryetar.

Ndërsa, procesi i integrimit po ashtu ka përfshirë 140 anëtarë të stafit mbështetës në institucionet gjyqësore nëpër Kosovë.

Ndonëse zyrtarisht të gjitha 15 pikat e marrëveshjes për drejtësinë janë zbatuar, ende mbetet shumë për tu bërë për ta arritur funksionalitetin e plotë të institucioneve gjyqësore në pjesën veriore të Kosovës. Përkatësisht, meqë stafi shqiptar dhe serb i Kosovës i caktuar për GjThM dhe divizionin e Gjykatës së Apelit në Mitrovicë kanë iniciuar kontakte profesionale për ta filluar rikthimin e funksioneve të plota gjyqësore në pjesën veriore të Kosovës, një numër çështjesh kanë dalë në punën e këtyre dy institucioneve të integruara kohëve të fundit.

Procesi i ngritjes së gjykatës në Mitrovicë ka filluar së pari me sigurimin e kushteve minimale për punë për shkak të gjendjes së ndërtesave të

riparuara. Andaj, rastet nga dega në Vushtrri (ku GjThM-ja ka qenë e vendosur përkohësisht deri në tetor të vitit 2017) dhe rastet nga gjykata që më parë janë administruar në pajtim me sistemin juridik të Serbisë në pjesën veriore të Mitrovicës janë transferuar në objektet e GjThM-së. Në aspektin logjistik, disa çështje ende nuk janë përfunduar, meqë nuk janë krijuar lidhje të intranetit apo të telefonit mes ndërtesës kryesore të gjykatës në Mitrovicën Veriore dhe objekteve të saj andej lumit në Mitrovicën Jugore, çka ndikon në komunikimin e përditshëm mes stafit që gjenden në të dy ndërtesat. Kjo gjendje ekziston pavarësisht faktit se marrëveshja për drejtësinë parasheh krijimin e shërbimeve të telefonisë, një varg të gjerë të shërbimeve të internetit dhe shërbimin postar efikas për t'ia mundësuar GjThM që të komunikojë me palët.

Pengesa gjuhësore menjëherë është bërë çështje urgjente për shkak të shërbimeve të përkthimit të nevojshme për ndërveprimet e përditshme mes gjyqtarëve dhe prokurorëve serbë të Kosovës dhe shqiptarë të Kosovës. Në qershor të vitit 2018, GjThM-ja i ka pasur katër përkthyes për 29 gjyqtarë dhe PTh-ja i ka pasur pesë përkthyes për 10 prokurorë: numër i pamjaftueshëm duke e marrë parasysh numrin e stafit dhe vëllimin e punës së gjykatës dhe prokurorisë. Përkthimi po ashtu ka qenë çështje me rastin e procesimit të komunikimeve me shkrim drejtuar GjThM-së. Ndonëse institucionet e Kosovës janë të detyruara me ligj që të gjitha dokumentet t'i prodhojnë në të dy gjuhët zyrtare, pra në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe, KGJK-ja është ballafaquar me vështirësi të brendshme për shkak të mungesës së përkthyesve për gjuhën serbe dhe ka vazhduar të komunikojë me GjThM-në në gjuhën shqipe. Ndërkaq, KPK-ja ka vepruar sipas rregullave. Të dy këshillat ende kanë

nevojë të sigurojnë që të gjitha rregulloret përkatëse të përkthehen në gjuhën serbe dhe të vendosen nëpër faqet e tyre përkatëse të internetit, në mënyrë që gjyqtarët dhe prokurorët serbë të Kosovës të mund t’iu qasen. Përveç kësaj, të gjitha lëndët e rasteve nga ish-GjThM-ja dhe PTh-ja në Vushtrri duhet të përkthehen në gjuhën serbe, ndërsa shkresat e lëndëve nga gjykata dhe prokuroria që më parë janë administruar në pajtim me sistemin juridik serb ende presin të përkthehen në shqip, duke krijuar kështu një sasi tejet të madhe të materialit të papërkthyer.

Pengesa gjuhësore po ashtu ka pasur ndikim tek sistemi i caktimit të rasteve që me ligj parashihet të bëhet “me short”. Që kur gjykata është bërë funksionale, rastet së pari janë ndarë sipas gjuhës, pastaj është bërë tërheqja me short në secilin grup përkatës. Ndonëse kjo përbën një zgjidhje të punës, kjo nuk është e preferueshme nga pikëpamja juridike dhe mund të mos garantojë shpërndarje të balancuar të vëllimit të punës.

Një sfidë tjetër – relevante për të dyja institucionet – është problemi i njohjes së diplomave. Kandidatët me diploma të Serbisë nuk kualifikohen për asnjë vend të punës në institucione të Kosovës pa njohjen e diplomave të tyre nga Kosova, duke i privuar këto të fundit nga të punësuar që gjuhën serbe e kanë amtare apo kanë aftësi të avancuar të gjuhës serbe. KPK-ja e ka inkurajuar Ministrinë e Administratës që të ndryshojë rregulloren për *Procedurat e punësimit në shërbimin civil* për

t’ua mundësuar kandidatëve me diploma nga Serbia që të fillojnë të punojnë në pritje të njohjes së tyre.

GjThM-ja po ashtu është ballafaquar me probleme për shkak të numrit të rasteve të papërfunduara. Sipas një vlerësimi të kryer nga EULEX-i, çdo gjyqtar për raste penale në Departamentin e Përgjithshëm të Krimeve në GjThM ka përafërsisht 700 raste, ndërsa çdo gjyqtar për raste penale në Departamentin për Krime të Rënda në GjThM i ka përafërsisht 250 raste, ndërsa çdo gjyqtar për raste civile ka më shumë se njëmijë raste për t’i gjykuar. Më tej, janë edhe rreth 800 raste penale dhe 2000 raste civile që ende presin t’u caktohen gjyqtarëve. Duke pas parasysh se mandati ekzekutiv gjyqësor i EULEX-it ka përfunduar në qershor të vitit 2018, i pasuar me dorëzimin e lëndëve të rasteve, numri i rasteve të papërfunduara të GjThM do të ngritët më tej pas përfundimit të procesit. Deri në qershor, vetëm një numër i vogël i rasteve janë shqyrtuar, çka tregon për një lëvizje shumë të ngadaltë të gjykimeve për një gjykatë që ka me mijëra raste në pritje. Vëllimi aktual i punës në PTh përbëhet prej 6558 rasteve në shqip dhe 400 rasteve në serbisht.

Duke qenë i përballur me këto sfida dhe të tjera, Kryetari i GjThM-së bëri përpjekje që të japë dorëheqje në shkurt të vitit 2018, por ishte bindur nga KGJK-ja që vendimin e tij ta tërhiqte. Ndonëse gjendja është pak më e mirë në PTh, të dyja institucionet kanë nevojë për vëmendje, përpjekje dhe burime shtesë për të arritur funksionalitet të plotë.

**RRUGA PËRPARA:** Duke e vërejtur gatishmërinë e përgjithshme të gjykatave të Kosovës për të funksionuar pa angazhim ndërkombëtar të integruar – dhe si rezultat i zbatimit të marrëveshjes për drejtësinë që ka dalë nga dialogu – EULEX-i i ka tërhequr gjyqtarët nga GjThM-ja në fund të mandatit të tij të mëparshëm më 14 qershor 2018, duke i dorëzuar të gjitha rastet e papërfunduara tek homologët vendas. Me qëllim të mbështetjes së mëtejme të procesit të integrimit në drejtësi në pjesën veriore të Kosovës, gjatë mandatit të ri EULEX-i do ta këshillojë kryetarin e GjThM-së dhe Kryesuesin e Divizionit të Gjykatës së Apelit në Mitrovicë.

## LISTA E SHKURTESAVE

PTh – Prokuroria Themelore

PP – Pikëkalim i Përbashkët

SIML – Sistemi Informativ për Menaxhimin e Lëndëve

BE – Bashkimi Evropian

EULEX – Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit

PSBE –Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian

FRONTEX – Agjencia Evropiane e Rojave Kufitare dhe Bregdetare

MIK/IBM – Menaxhimi i Integruar i Kufirit

IML – Instituti i Mjekësisë Ligjore

FPADh – Funksionimi i Policisë në bazë të Analizës dhe të Dhënave

IPA – Instrumenti i Para-Antarësimit

BPSL – Bordi i Përbashkët Bashkërendues për Sundim të Ligjit

KFOR –Forca në Kosovë

ShKK – Shërbimi Korrektues i Kosovës

KGjK – Këshilli Gjyqësor i Kosovës

PK – Policia e Kosovës

AKP – Agjencia Kosovare e Pronës

KPK- Këshilli Prokurorial i Kosovës

AKKVP – Agjencia e Kosovës për Krahasim dhe Verifikim të Pronës

GjThM – Gjykata Themelore e Mitrovicës

MUP – Ministarstvo unutrašnjih poslova/ Ministria e Brendshme (Serbi)

IPK – Inspektorati Policor i Kosovës

DhPGjS – Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme

PSRK – Prokuroria Speciale e Kosovës

European Union Rule of Law Mission  
*Partnership for Justice*



[www.twitter.com/eulexkosovo](https://www.twitter.com/eulexkosovo)



[www.facebook.com/eulexkosovo](https://www.facebook.com/eulexkosovo)



[www.youtube.com/eulexkosovo](https://www.youtube.com/eulexkosovo)